



MARRËVESHJET E FAJËSISË



Si po shpërfaqet përdorimi i këtij mjeti të ri juridik dhe si mund të balancohet roli i palëve për një marrëveshje (më) të ndershme



Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Qendrës Res Publica dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton opinionin e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.


Botues: Qendra “Res Publica”

Redaktor: Dorian Matlija

Tirazhi: 100 kopje

Layout & Print: Expo Vision Albania

MARRËVESHJET E FAJËSISË



Si po shpërfaqet përdorimi i këtij mjeti të ri juridik dhe si mund të balancohet roli i palëve për një marrëveshje (më) të ndershme

PERMBAJTJA

5 Hyrje

7 Metodologjia

9 Vështrim i gjykimeve me marrëveshje në legjislacione të huaja

9 Gjykimet si mall tregtie: negocimi për një dënim më të mirë në tregun e së drejtës

12 Bërja e një oferte që i pandehuri nuk mund ta refuzojë: roli mbizotërues i prokurorëve të SHBA në procedurat e negocimit të fajësisë

16 Shndërrimi i sistemeve të heqjes dorë nga gjykimi në sisteme funksionalë: Arritja e një marrëveshjeje (më) të ndershme

21 Gjykimet me marrëveshje sipas legjislacionit shqiptar

21 Gjykimi me marrëveshje, risi për drejtësinë penale shqiptare

21 Avantazhet dhe disavantazhet

22 Roli i aktorëve kryesorë në marrëveshjet e pranimit të fajësisë

28 Kufizimet në gjykimet me marrëveshje

31 Të dhëna nga studimi i gjykimeve me marrëveshje fajësie në praktikë

31 Raporti i çështjeve të cilat eventualisht mund të gjykohen me marrëveshje me çështjet që eventualisht mund të gjykohen me procedurë të rregullt

32 Raporti i çështjeve të gjykuara me marrëveshje në praktikë gjatë vitit 2018, në krahasim me të gjitha çështjet që mund të ishin gjykuar me marrëveshje fajësie në teori

33 Llojet e veprave penale për të cilat është arritur marrëveshje fajësie

35 Raporti i marrëveshjeve të lidhura mes prokurorit dhe të pandehurit, në krahasim me ato që janë pranuar nga gjykata

| | |
|----|--|
| 35 | Raporti i gjykimeve me marrëveshje, ku i pandehuri është mbrojtur nga një avokat i zgjedhur dhe me avokatë të caktuar kryesisht |
| 36 | Raporti i marrëveshjeve të rrëzuara nga gjykata në çështjet me avokat të zgjedhur, kundrejt atyre me avokat të caktuar kryesisht |
| 36 | Përfaqësimi i të pandehurit nga i njëjti avokat, si në fazën hetimore, ashtu edhe gjatë gjyqimit |
| 37 | Shpeshtësia e gjykimeve me marrëveshje gjatë Janar 2018 – Prill 2019 |
| 38 | Të dhëna nga gjykatat e rretheve |
| 40 | Masa e dënimeve kur i pandehuri është mbrojtur nga një avokat i zgjedhur në raport me rastet kur është mbrojtur nga një avokat i caktuar kryesisht |
| 41 | Dënimi mesatar për veprat në gjykimin e zakonshëm, krahasuar me mesataren e dënimit në gjykimin me marrëveshje |
| 42 | Marrja para sysh e preferencave të të pandehurit në caktimin e një avokati kryesisht |
| 43 | Arsyetimi i vendimeve gjyqësore për pranimin e marrëveshjes, në lidhje me konfirmimin e vullnetit të të pandehurit |

45 Përfundime dhe rekomandime

| | |
|----|-------------|
| 45 | Përfundime |
| 50 | Rekomandime |

HYRJË

Ky studim u krye në kuadër të projektit: *“Promovimi i skemës së ndihmës juridike në fushën penale në Shqipëri”*, i mbështetur nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur, Hungari. Ky studim vjen në vazhdimësinë e një studimi tjetër të mëhershëm të kryer nga Qendra “Res Publica”, *“Mbi efektivitetin e ndihmës juridike në Shqipëri”*¹. Qëllimi kryesor i këtij studimi është vlerësimi i efektivitetit të ndihmës juridike në Shqipëri, në praktikën e gjykimeve me marrëveshje fajësie. Kjo procedurë është një lloj i veçantë gjykimi në procesin penal, i prezantuar për herë të parë në legjislacionin shqiptar në vitin 2017, në kuadër të reformës në drejtësi. Kjo praktikë ka në thelb pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, në këmbim të një dënimi më të butë. Në këtë lloj gjykimi, i pandehuri heq dorë nga disa të drejta procedurale, më e rëndësishmja e të cilave është heqja dorë nga prezumimi i pafajësisë, gjë e cila e vë të pandehurin në pozitë cenimi e që për pasojë e bën të dosmosdoshme mbrojtjen e tij në mënyrë sa më efektive. Është për këtë arsye që roli i avokatit në këtë lloj gjykimi është tepër i rëndësishëm dhe avokatët e caktuar kryesisht, sipas skemës së ofrimit të ndihmës juridike falas, duhet të kenë një nivel të lartë përgatitje dhe përgjegjshmërie.

Për të vëzhguar nga afër si funksionon skema e ndihmës juridike në rastet e gjyqimit me marrëveshje, vlerësuam legjislacionin dhe praktikën ligjore në gjyqimet me marrëveshje në raport me standardet ndërkombëtare, me fokus të veçantë garancitë për ndihmën që ofrohet nga avokatët e caktuar nga shteti për ata individë që nuk kanë mjete për ta siguruar vetë ndihmën juridike, në gjyqimet me marrëveshje.

Studimi është i ndarë në 4 pjesë kryesore:

- Në pjesën e parë, janë analizuar gjyqimet me marrëveshje në vende të zhvilluara, ku përdorimi i tij është shumë i përhapur, si SHBA, etj., dhe praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila ka vendosur disa standarde lidhur me këto gjykime.
- Në pjesën e dytë, është analizuar legjislacioni vendas, lidhur me institutin e gjykimeve me marrëveshje, me qëllim vlerësimin e rolit të aktorëve kryesorë në këtë procedurë të

1 <https://www.osfa.al/publikime/efektiviteti-i-ndihmes-juridike-ne-procesin-penal-ne-shqiperi>

posaçme gjykimi; prokurorit, gjykatës dhe mbrojtësit të të pandehurit.

- Në pjesën e tretë, janë analizuar të dhënat e mbledhura nga studimi i dosjeve penale, me qëllim prezantimin e situatës së gjykimeve me marrëveshje në përgjithësi dhe shërbimit të ofruar nga avokatët e caktuar kryesisht në këto lloj gjykimesh, në veçanti.
- Në pjesën e fundit jepen përfundimet dhe rekomandimet që rezultojnë nga studimi, të cilat kanë në fokus realizimin e të drejtës së individëve për të pasur një mbrojtje më efektive në gjykimin me marrëveshje, si gjykim i posaçëm në procesin penal, si element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

Autorët e studimit janë:

- Av. Dorian Matlija
- Dr. Irene Dule
- Av. Theodoros Alexandridis
- Loreno Nikolli



METODOLOGJIA

Qëllimi kryesor i studimit është theksimi i rëndësisë së efektivitetit të shërbimit të ndihmës juridike të ofruar falas, në shërbim të interesit të drejtësisë në vetvete, pasi sigurimi i një mbrojtjeje efektive është element kyç në garantimin e gjykimit të drejtë. Sidomos në çështjet penale një mbrojtje efektive është garanci për respektimin e të drejtave procedurale, të cilat janë drejtpërdrejt të lidhura me të drejtat themelore të njeriut.

Për të realizuar qëllimin e mësipërm u fokusuam në vlerësimin e praktikës së gjykimeve me marrëveshje në përgjithësi dhe cilësisë së mbrojtjes në gjykimet me marrëveshje në veçanti, duke e ndarë studimin në tre drejtime:

Së pari, u studiua instituti i gjykimit me marrëveshje në disa legjislacione të huaja, si ai i SHBA dhe në disa vende të tjera në rajon, ku këto lloj gjykimesh janë shumë të përhapura; u studiuan standardet e vendosura nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila kërkon që disa elementë të jenë të përmbushur me qëllim që praktikatat e marrëveshjeve të fajësisë të mos cenojnë të drejtat e njeriut. Të gjithë këto elementë janë marrë parasysh në studimin në vijim, për të parë se sa legjislacioni dhe praktika juridike në Shqipëri i garanton këto të drejta.

Së dyti, u mor në analizë legjislacioni vendas në këtë fushë, me qëllim vlerësimin e rolit të aktorëve kryesorë që marrin pjesë në këtë lloj gjykimi, konkretisht të prokurorit, gjykatës dhe mbrojtësit të të pandehurit. Duke vlerësuar këto role, është më i lehtë konstatimi i mangësive dhe problemeve të mundshme që mund të adresohen nga mbrojtësi i caktuar nga shteti, sipas skemës së ofrimit të ndihmës juridike falas, e marrë në analizë për efekt të këtij studimi.

Së treti, u mblodhën të dhëna nga shqyrtimi i 398 vendimeve në gjykime me marrëveshje, të shqyrtuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vitin 2018 dhe gjatë katër mujorit të parë të vitit 2019. Prej tyre, u përzgjedhën për t'u vlerësuar më në detaje, 100 vendime penale, ku në 50 prej këtyre çështjeve, të pandehurit u mbrojtën nga avokatë të zgjedhur nga ai vetë dhe në 50 të tjera, të pandehurit u mbrojtën nga avokatë të caktuar kryesisht.

Të dhënat u vlerësuan për të analizuar preferencën e këtij lloj gjykimi në praktikën gjyqësore; cilësinë e mbrojtjes së të pandehurit, që rezulton nga diferencat domethënëse në cilësinë e punës së avokatëve kryesisht, krahasuar me ata të zgjedhur nga vetë të pandehurit.

Arsyeja pse u zgjodh Gjykata e Tiranës për të bërë këtë studim, gjendet në faktin se Tirana është qyteti me popullsi më të madhe, gjë që e bën të mundur kampionimin dhe dhënie të statistikave për shkak të numrit të madh të çështjeve që trajton. Nga ana tjetër numri i madh i çështjeve bën që të ketë më shumë gjasa të ketë një *"konkurrencë"* të dukshme mes avokatëve të caktuar kryesisht dhe atyre të zgjedhur nga vetë të pandehurit.

III. VËSHTRIM I GJYKIMEVE ME MARRËVESHJE NË LEGJISLACIONE TË HUAJA

1. Gjykimet si mall tregtie: negociimi për një dënim më të mirë në tregun e së drejtës

“Realiteti është se drejtësia penale sot është, në pjesën më të madhe, një sistem lutjesh, jo një sistem gjyqesh ... “tregtia e kuajve” [ndërmjet të pandehurit dhe prokurorisë] përcakton se kush shkon në burg dhe për sa kohë. Ato [bisedimet mbi pranimin e fajësisë] nuk janë thjesht ndihmesë e sistemit të drejtësisë penale; ato janë vetë sistemi i drejtësisë penale ... “[Të pandehurve] që u shkon çështja e tyre në gjyq dhe humbasin, marrin dënime më të rënda sa edhe Kongresi ose prokurori mund t’i mendojnë të përshtatshme, sepse dënimet më të rënda ekzistojnë në libra kryesisht për qëllime negociuese. Kjo shpesh rezulton në dhënie të dënimeve më të lehta atyre individëve, që pranojnë marrëveshjen e fajësisë krabasuar me individët e tjerë që janë moralisht më pak fajtorë, por provojnë fatin e tyre dhe e dërgojnë çështjen në gjyq”.

Cituar nga Gjyqtari i Gjykatës Supreme të SHBA, Kennedy²

Kompleksiteti i shoqërive moderne, rregullimi ligjor i një numri në rritje të aktiviteteve të përditshme së bashku me shfaqjen e formave të reja dhe të komplikuar të kriminalitetit dhe nevoja e njëkohshme për t’i luftuar ato në mënyrë efektive kanë zhdukur gradualisht jo vetëm masat mbrojtëse të procedurës penale, por edhe vetë konceptin e aksesit në gjykatë. Në të vërtetë, për një numër gjithnjë në rritje të të pandehurve në mbarë botën, çështjet nuk janë shqyrtuar nga një gjykatë, por janë mbyllur pas një marrëveshjeje mes tyre dhe prokurorit. Kjo marrëveshje ofron disa përfitime për të pandehurin dhe zakonisht mund të jetë subjekt i një shqyrtimi formal nga një gjyqtar, ndërkohë që i pandehuri heq dorë nga disa të drejtat procedurale.

² Gjykata Supreme e SHBA, Missouri k. Frye, 566 U.S. 134, 2012, e aksesueshme në: <https://supreme.justia.com/cases/federal/us/566/134/>

Sipas *Fair Trials International*, që është një organizatë ndërkombëtare e mirënjohur në fushën e të drejtave të mbrojtjes në proceset penale, këto praktika quhen “heqje dorë nga gjyqi” dhe mund të përcaktohen si procese që: “... nuk ndalohen me ligj, sipas të cilit i pandehuri bie dakord të pranojë fajin dhe/ose bashkëpunojë me autoritetet e hetimit në këmbim të disa përfitimeve nga shteti, më së shpeshi në formën e reduktimit të akuzave dhe/ose dënimeve më të ulëta.”³

Përdorimi i heqjes dorë nga gjyqi është përhapur, në mbarë botën. Ndërsa në vitin 1990 vetëm 19 vende në botë kishin bërë pjesë të praktikave të tilla në sistemet e tyre ligjore, në vitin 2015 ky numër u rrit në 66.⁴ Për më tepër, shumica e këtyre vendeve miratuan jo vetëm një lloj, por shpesh praktika të shumta të heqjes dorë nga gjykimi, duke filluar nga praktikat e heqjes dorë nga gjykimi për kundërvajtjet e deri te sistemet më të komplikuar që parashikojnë stimuj për të pandehurit me qëllim për të bashkëpunuar me autoritetet dhe për të siguruar informata vendimtare kundër të pandehurve të tjerë.

Termi “heqje dorë nga gjykimi” është gjenerik, pasi sisteme të tilla janë përshtatur nën një shumëllojshmëri emrash, duke filluar nga emra shumë të njohur si “marrëveshjet e pranimit të fajit” (që kanë fituar famë nga kinematografia amerikane), deri te emra më pak të njohur si “gjykime të përmbledhura”. Megjithatë, pavarësisht nga emri i tyre, e përbashkëta e këtyre sistemeve është pikërisht elementi i marrëveshjes, që është negociimi ndërmjet një zyrtari gjyqësor (shpesh prokuror) dhe të pandehurit, ku ky i fundit pajtohet me një element thelbësor të dosjes kundër tij dhe/ose pranon fajin në këmbim të heqjes së disa akuzave ose zvogëlimit të dënimit.

Arsyeja kryesore që e ka shtuar popullaritetin gjithnjë në rritje të sistemeve të heqjes dorë nga gjykimi është pikërisht fakti që, nëse zbatohet siç duhet, të dyja palët përfitojnë. Kështu autoritetet hetuese dhe gjykatat mund të disponojnë me shpejtësi dhe me efikasitet çështje të shumta që përndryshe do të merrnin kohë dhe do të shpenzonin burime të vlefshme policore dhe gjyqësore (dhe madje, në rastet e bashkëpunësorëve të drejtësisë, do i detyronin ata të zhvillonin hetime më të thelluara dhe të vështira), ndërsa të pandehurit mund të marrin një dënim më të ulët se ai që do të bënin po të refuzonin marrëveshjen, si dhe mund të shmangin një paraburgim të gjatë. Për më tepër, marrëveshje të tilla në parim nuk janë në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim Gjykata) që vlerëson se marrëveshja e fajësisë është efektive një heqje dorë nga një sërë të drejtash procedural. Sipas gjykatës kjo heqje dorë nuk ngre asnjë çështje sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për sa kohë që ajo është e vetëdijshme dhe e kuptuar, janë saktësuar në mënyrë të qartë elementët e saj, respektohet një minimum mbrojtjeje në përpjesëtim me rëndësinë e të drejtave nga të cilat është hequr dorë dhe së fundmi nuk është kundër ndonjë interesi të rëndësishëm publik.⁵ Në një rast Gjykata vë në dukje se aplikanti kishte pranuar me gatishmëri marrëveshjen e pranimit të fajësisë, se ai kishte qasje të plotë në dosjen e çështjes, se gjatë gjithë procedurës ai ishte përfaqësuar nga dy avokatë të zgjedhur prej tij, që ai pohoi shumë herë se ai kishte kuptuar kushtet e pranimit të fajit, marrëveshja dhe pasojat që i shkakttoheshin atij dhe se marrëveshja e fajësisë u shqyrtua përfundimisht nga një gjykatë e cila nuk ishte e detyruar të pranonte medoemos kushtet e saj. Në këtë rast Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte ndodhur ndonjë shkelje e së drejtës së kërkuesit për një gjykim të drejtë të mbrojtur sipas nenit 6 të Konventës⁶. Gjykata

3 Fair Trials International, *The Disappearing Trial: Towards a rights-based approach to trial waiver systems*, e aksesueshme në: <https://www.fairtrials.org/wpcontent/uploads/2017/12/Report-The-Disappearing-Trial.pdf>, faqe 2.

4 Po aty, faqe 4.

5 *Natsvlshvili and Togonidze v. Georgia*, nr. 9043/05, 29 Prill 2014, paragraf 91.

6 Po aty, paragrafët 92-98.

ka arritur konkluzione të ngjashme në lidhje me pajtueshmërinë e sistemit të gjyqimit të shkurtuar (*giudizio abbreviato*) me nenin 6 të Konventës, duke vënë në dukje se heqja dorë nga e drejta e kërkesit për një gjykim publik dhe e drejta për të kërkuar marrjen e dëshmimeve dhe dokumenteve shkresore ishin kundërpeshuar nga një sërë përfitimesh të dhëna ndaj aplikantit, duke përfshirë një reduktim të konsiderueshëm të dënimit dhe ndalimin e prokurorit për të paraqitur ankim, me përjashtim të rasteve kur gjykata me vendimin e saj mund të ndryshonte kualifikimin ligjor të veprës penale.⁷

Në dritën e kësaj pamjeje rozë, siç përshkruhet më lart, është e vështirë të kuptohet pse dikush do të kundërshtonte përdorimin e sistemeve të heqjes dorë nga gjykimi dhe do ishte skeptik për përhapjen e tyre dhe për dominimin pothuajse të plotë në disa vende. Vlerësohet se mbi 97% e të pandehurve federalë dhe 94% e të pandehurve të shteteve në SHBA dënohen në bazë të një marrëveshjeje fajësie me prokurorin dhe jo përmes gjyqimit të rregullt.⁸ Përqindje të ngjashme janë vënë re edhe në vendet e tjera që kanë miratuar një sistem të volitshëm për pranimin e fajësisë si rasti i SHBA. Kështu, në Gjeorgji, ndërsa vetëm 12,5% të çështjeve u zgjidhën me marrëveshjen e fajësisë në vitin 2005, përqindja arriti në 87,8% shtatë vjet më vonë.⁹ Në mënyrë të ngjashme në Kolumbi, ndërmjet viteve 2005 dhe 2007, më pak se 2% e rasteve shkuan në gjyq, ndërsa pjesa tjetër u përfundua me anë të një marrëveshjeje për pranimin e fajësisë.¹⁰ Megjithatë, përveç këtyre rasteve, përqindjet në vendet e tjera janë mjaft të ulëta: kështu në Itali, në periudhën 2001-2010, forma italiane e marrëveshjes së pranimit të fajësisë, e konsideruar si aplikim i dënimit me kërkesë të palëve (*patteggiamento sulla pena*), ishte zbatuar vetëm në rreth 15,5 % të rasteve¹¹ ndërsa edhe në Gjermani, me sistemin e saj të bisedimeve kryesisht joformale dhe të parregulluara, vetëm rreth 50% e rasteve janë zgjidhur në bazë të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë.¹² Të bën kurioz fakti se edhe vendet që kanë prezantuar marrëveshjen e pranimit të fajësisë sipas mënyrës që aplikohet në SHBA nuk duket se e kanë përqafuar plotësisht, ose fare. Kështu për shembull në Kroaci, në vitin 2017, vetëm 3,96% të rasteve përfunduan me një vendim të bazuar në marrëveshjen e palëve (forma kroate e marrëveshjes së fajësisë)¹³, ndërsa në Moldavi përqindja mund të jetë

7 *Hermi v. Italy* [GC], nr. 18114/02, 18 Tetor 2016, paragraf 78.

8 Bagaric, Mirko, Clarke, Julie, Rininger, William, *Plea Bargaining: From Patent Unfairness to Transparent Justice*, Missouri Law review, Volumi 84, Dimër 2019, Numër 1, e aksesueshme në: <https://scholarship.law.missouri.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=4364&context=mlr>, faqe 2. Të dhënat janë për vitin 2014.

9 Fair Trials International, *The Disappearing Trial: Towards a rights-based approach to trial waiver systems*, faqe 32.

10 Cituar nga McLeod, Allegra M., *Exporting U.S. Criminal Justice*, 29 Yale L. & Policy Review. 83-164, 2010, e aksesueshme në: <http://scholarship.law.georgetown.edu/facpub/1278>, faqe 149, shënimi nr. 300.

Në mënyrë interesante, përqindja bie në 34,5% në vitin 2014; Fair Trials International, *The Disappearing Trial: Towards a rights-based approach to trial waiver systems*, faqe 34.

11 Luparia Luca, Gialuz Mitja, *Italian Criminal Procedure: Thirty Years After the Great Reform*, 2019, e aksesueshme në: <http://193.205.139.95/ojs/index.php/law/article/download/1867/1857>, faqe 66.

12 Frommann, Maike, *Regulating Plea-Bargaining in Germany: Can the Italian Approach Serve as a Model to Guarantee the Independence of German Judges?*, *Comparative Law / Rechtsvergleichung*, 2009, e aksesueshme në: <http://hanselawreview.eu/wp-content/uploads/2016/08/Vol5No2Art04.pdf>, faqe 200.

13 Ivičević Karas, Elizabeta, *Trial Waiver Systems in Croatia: Towards a rights-based approach to trial waiver systems*, Fair Trials International, *Report produced through LEAP*, 2019, e aksesueshme në: <https://www.fairtrials.org/publication/trial-waiver-systems-croatia>, faqe 4.

rreth 49%.¹⁴ Së fundmi, në Maqedoninë e Veriut, përqindja e rasteve të përfunduara pas një marrëveshjeje për pranimin e fajësisë ishte rreth 66% në vitin 2014¹⁵, por ende shumë më e ulët se përqindjet ekuivalente në SHBA apo Gjeorgji. Në bazë të asaj që u tha më lart, lind një pyetje legjitime, nëse forma kryesore e SHBA-së e heqjes dorë nga gjykimi, përkatësisht marrëveshja e fajësisë, është vërtet e efektshme apo popullariteti i saj është rezultat i faktorëve të tjerë, më pak beninjë.

2. Bërja e një oferte që i pandehuri nuk mund ta refuzojë: roli mbizotërues i prokurorëve të SH.B.A.-së në procedurat e negociimit të fajësisë

“[Negocimi i fajit] është vështirë, nëse aspak, i dallueshëm në parim nga një shitje e drejtpërdrejtë e drejtësisë.”

Gjykata e Lartë e Wisconsin, 1877¹⁶

“Në çdo rast, Prokurori ka më shumë pushtet mbi administrimin e drejtësisë sesa gjyqtarët, me një vlerësim më të vogël të pushtetit së tij, nga publiku. Ne kemi qenë xbeloz për fuqinë e gjyqtarit, por pa u kujdesur për rritjen e vazhdueshme të fuqisë së prokurorisë.”

Komisioni Kombëtar për Mbikëqyrjen dhe Zbatimin e Ligjit, Raport mbi Prokurorinë 11, 1931¹⁷

“Prokurori ka më shumë kontroll mbi jetën, lirinë dhe reputacionin se çdo person tjetër në Amerikë. Liria e tij është e jashtëzakonshme.”

Prokurori i Përgjithshëm i SHBA Robert H. Jackson, 1940¹⁸

Duke marrë parasysh karakteristikat unike të institucionit të Prokurorisë së Shteteve të Bashkuara (edhe sot, në të gjitha shtetet, përveç katër shteteve të SHBA dhe në Distriktin e Kolumbisë, prokurori zgjidhet nga publiku dhe nuk emërohet nga shteti)¹⁹ ose për shkak të futjes relativisht vonë të marrëveshjes së fajësisë në ligjin amerikan, edhe në dritën e refuzimit

14 Alkon, Cynthia, *Plea Bargaining as a Legal Transplant: A Good Idea for Troubled Criminal Justice Systems*, 19 *Transnational Law and Contemporary Problems* 355, 2010, e aksesueshme në: <http://scholarship.law.tamu.edu/facscholar/268>, faqe 411.

Profesionistët vendas kanë ngritur shqetësimin për saktësinë e këtyre statistikave dhe argumentojnë se marrëveshja e fajësisë përdoret rrallë. Po aty.

15 Misoski, Boban, *Delayed Justice – Macedonian Experience With Guilty Plea and Sentence Bargaining*, *South East European University Review, Special Edition*, Volume 11, Issue 1, 2015, e aksesueshme në:

<https://philpapers.org/rec/MISDJ>, faqe 104.

16 Gjykata Supreme e Wisconsin, *Wight v. Rindskopf*, 43 Wis. 344, 354 (1877), cituar Dervan, Lucian E., *Class v. United States: Bargained Justice and a System of Efficiencies*, *Cato Supreme Court Law Review*, 2018, e aksesueshme në:

https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=3293868, faqe 121.

17 Cituar në Davis, Angela J, *Arbitrary Justice: The Power of the American Prosecutor*, Oxford University Press, 2007, faqe 11.

18 *Address entitled “The Federal Prosecutor” delivered at the Second Annual Conference of United States Attorneys*, zhvilluar në 1940. Aksesohet në:

https://www.roberthjackson.org/wp-content/uploads/2015/01/The_Federal_Prosecutor.pdf

19 Po aty, faqe 10.

të mëparshëm të gjykatave amerikane²⁰, është shumë e çuditshme që një nga kompetencat kyçe të Prokurorit të Shteteve të Bashkuara, përkatësisht të marrëveshjes së fajësisë, është miratuar tashmë nga kaq shumë shtete të tjerë në formën e ngjashme me atë në SHBA. Një arsye e mundshme mund të qendrojë në faktin se shumica e asistencës juridike për shtetet e tjerë, e dhënë drejtpërdrejt (dhe jo në mënyrë të tërthortë nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID) nga Qeveria e SHBA administrohet nga Zyra e Departamentit të Drejtësisë të SHBA (Ndihma dhe Trajnimi për Zhvillimin e Prokurorisë jashtë SHBA (OPDAT). OPDAT përbëhet nga prokurorë amerikanë të stacionuar jashtë vendit, mënyra e të menduarit e të cilëve është shumë natyrshëm e ndikuar shumë nga përvoja e tyre e punës në SHBA dhe që si rezultat shpesh advokojnë për një qasje të përqendruar në prokurori të projekteve / iniciativave të ndryshme gjyqësore në vendet ku vepron OPDAT, shpesh duke i kushtuar më shumë rëndësi çështjeve që shqetësojnë SHBA (si terrorizmi apo krimi i organizuar) që mund ose jo të kenë rëndësi të barabartë në vendin ku ata punojnë. Po aq e rëndësishme, dhe duke pasqyruar praktikën e prokurorëve në SHBA, OPDAT i kushton vëmendje të vogël të drejtave procedurale penale pasi mbështetet kryesisht - nëse jo vetëm - në marrëveshjet për pranimin e fajësisë me qëllim që të mbyllin në një kohë sa më shkurtër çështjet.²¹

Prandaj është e rëndësishme që shkurtimisht të përshkruhen shqetësimet kryesore që janë shprehur në lidhje me diskrecionin e paarsyeshëm që prokurorët e SHBA gëzojnë, jo vetëm për të krahasuar stilin amerikan të marrëveshjes për pranimin e fajësisë me forma të tjera të sistemeve të ngjashëm të heqjes dorë nga gjykimi, por më e rëndësishmja për të identifikuar mangësitë e mundshme që duhet të shmangen.

Bisedimet për pranimin e fajësisë në SHBA zakonisht janë një proces shumë joformal, me negociata ndërmjet prokurorit dhe avokatit të të pandehurit, që ndodhin jashtë sallës së gjyqit. Këto negociata përbëhen nga oferta dhe kundër-oferta të të dyja palëve, të cilat megjithatë nuk bëhen në kushte të barabarta, pasi prokurori ka më shumë burime në dispozicion, se i pandehuri dhe avokati i tij, veçanërisht nëse ky i fundit përfaqësohet nga një mbrojtës publik (i caktuar kryesisht). Kjo mund të bëhet në çdo kohë pas marrjes së vendimit për të komunikuar akuzën, apo edhe para se të ngrihen akuza formale. Marrëveshja për pranimin e fajësisë mund të marrë formën e një *marrëveshjeje për akuzat* (ku i pandehuri pajtohet të pranojë fajësinë në këmbim të rënies së disa akuzave ose zëvendësimin e tyre nga më pak të rënda), ose të *marrëveshjes së dënimit* (ku prokurori pajtohet të rekomandojë një dënim më të vogël në këmbim të pranimit të fajit). Sidoqoftë, mjaft interesant është fakti që prokurorët nuk janë të detyruar t'i ofrojnë të pandehurve një marrëveshje në çdo rast; përkundrazi, i takon prokurorit të vendosë nëse do të ofrojë një marrëveshje dhe se çfarë do ofrojë. Oferta e prokurorit mund të ndikohet nga dy rrethana (p.sh. natyra e veprës penale, të dhënat penale të mëparshme të të pandehurit) dhe arsyet përtej ligjit (p.sh. raca e të pandehurit, interesi i medias në çështje, marrëdhënia e prokurorit me avokatin e të pandehurit, nëse zgjedhjet e radhës për prokurorin janë afër, e kështu me radhë). Prokurorët shpesh vendosin data skadence për ofertat e tyre për pranimin e fajësisë, duke e bërë të vështirë, nëse jo të pamundur, që avokatët të ndihmojnë në mënyrë domethënëse klientët e tyre. Një tjetër strategji e përdorur nga prokurorët është ajo e mbingarkimit të akuzave (e njohur si *charge-stacking*), ku një prokuror ngre akuza të shumëfishta, edhe nëse disa ose shumica e tyre janë të pavlefshme, ose që nuk mund të provohen përtej dyshimit të arsyeshem. Arsyetja e mbingarkesës me shumë akuza

20 Sipas Dervan, sistemi i sotëm i heqjes dorë nga gjykimi e ka origjinën në fillim të viteve 1900; është ngulitur më pas në kohën e prohibicionit (ndalimit të alkoolit) dhe të kriminalizimit të jetës së përditshme, të cilat sollën mbingarkesën e gjykatave; shih Dervan, Lucian E., *Class v. United States: Bargained Justice and a System of Efficiencies*, faqe 121.

21 McLeod, Allegra M., *Exporting U.S. Criminal Justice*, faqet 124 – 125, 139, 147.

është dhënia e një avantazhi shtesë për prokurorin, duke i dhënë atij më shumë leva gjatë negociatave me avokatin e të pandehurit. Në të kundërt, veprimi i vetëm në dispozicion i avokatit është që të nisë hetimet në mënyrë që të paraqesë dëshmi të pafajësisë së klientit të tij ose të identifikojë dobësitë ligjore në rastin e prokurorit kundër klientit²², duke punuar nën disavantazh të shtuar sepse prokurorët nuk janë të detyruar të bëjnë të ditur provat gjatë negociatave për marrëveshjen e fajësisë.²³ Sikur mos të mjaftonte sa më sipër, i pandehuri dhe avokati i tij duhet të marrin parasysh faktin se nëse ata vendosin të refuzojnë ofertën për pranimin e fajësisë dhe të shkojnë në gjyq, atëherë nëse shpallen fajtorë, dënimi mesatar që mund të merrni do të ishte, -pas vitit 2015,- më shumë se trefishi i dënimit mesatar pas pranimit të fajit (i ashtuquajtur i “*ndëshkëim për dërgimin e çështjes në gjyq*”).²⁴ Kjo, në një masë të madhe për shkak të ligjeve të detyrueshme të dënimit të cilat janë të detyrueshme për gjyqtarët, por jo për prokurorët (me fjalë të tjera, prokurori mund të propozojë një dënim që është edhe më i ulët sesa minimumi ligjor i zbatueshëm në rast të dënimit). Dhe ndërsa i pandehuri mund të ketë mundësinë e ngritjes së akuzave kundër prokurorit për çdo shkelje procedurale, ai duhet gjithashtu të jetë i vetëdijshëm se gjykatat amerikane hezitojnë të ushtrojnë çfarëdo lloj kontrolli mbi diskrecionin e prokurorisë²⁵ dhe çuditërisht (e thënë me keqardhje) pak prokurorë kanë qenë përgjegjës për shkelje të detyrës.²⁶ Sapo palët të kenë rënë dakord me kushtet e marrëveshjes së pranimit të fajësisë, kjo e fundit i dërgohet gjykatës për miratimin e saj. Edhe pse në parim gjykata mund të refuzojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë për një numër arsyes, në praktikë kjo ndodh vetëm në raste të jashtëzakonshme.²⁷

Nuk është surprizues fakti që sistemi i negociatave për marrëveshjen e fajësisë në SHBA ka pasur kritika të ashpra. Vetë fakti që në vitin 2016, 44.5% e të dënuarve që fituan më pas pafajësinë në SHBA kishin të bënin me të pandehurit që ishin shpallur fajtor me anë të një

- 22 Shih në përgjithësi, Angela J, *Arbitrary Justice: The Power of the American Prosecutor*, Kapitulli Tre. Për problemet me të cilat përballen avokatët e caktuar kryesisht në kontekstin e negociatave të marrëveshjes së fajësisë, shih Stain, Jeffrey, *How to Make an Innocent Client Plead Guilty*, artikull i publikuar në Washington Post, 12 Janar 2018, e aksesueshme në: https://www.washingtonpost.com/opinions/why-innocent-people-plead-guilty/2018/01/12/e05d262c-b805-11e7-a908-a3470754bbb9_story.html?noredirect=on&utm_term=.ed4cb02f1177
- 23 Petegorsky, Michael Nasser, *Plea Bargaining in the Dark: the Duty to Disclose Brady Evidence During Plea Bargaining*, *Fordham Law Review*, Volume 81 Issue 6, 2013, e aksesueshme në: <https://ir.lawnet.fordham.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=4913&context=flr>, faqe 3602.
- 24 Raporti *The Trial Penalty* nga National Association of Criminal Defence Lawyers and Foundation for Criminal Justice: *The Sixth Amendment Right to Trial on the Verge of Extinction and How to Save it*, 2018, e aksesueshme në: <http://www.nacdl.org/trialpenaltyreport>, faqe 15.
- 25 Kështu, sipas Gjykatës Supreme të SHBA: “Në sistemin tonë të drejtësisë penale, Qeveria mban “diskrecion të gjerë “se kush duhet të ndiqet penalisht ... Ky diskrecion i gjerë mbështetet kryesisht në dijeninë se vendimi për të ndjekur penalisht është veçanërisht i pa përshtatshëm për t’u përballur me shqyrtimin gjyqësor. [...] Kontrolli gjyqësor në këtë fushë, për më tepër, përfshin kosto sistemike që përbejnë shqetësim të veçantë. Shqyrtimi i bazës faktike që sjell prokurori vonon procesin penal, kërcënon të frenojë zbatimin e ligjit duke i vënë në pikëpyetje motivet e prokurorit dhe marrjen e vendimeve të tij për hetimin dhe mund të minojë efektivitetin e prokurorisë duke zbuluar politikatat e Qeverisë për zbatimin me forcë të ligjit. Të gjitha këto janë shqetësime thelbësore që i bëjnë gjykatat të hezitojnë për të shqyrtuar vendimin nëse do të duhet të ndiqet dikush penalisht.” Shih *Wayte v. United States*, 470 U.S. 598 (1985), në dispozicion në: <https://supreme.justia.com/cases/federal/us/470/598/>, faqe 470. U.S. 608.
- 26 Davis, Angela J, *Arbitrary Justice: The Power of the American Prosecutor*, Kapitulli 9 dhe veçanërisht seksioni me titull “*Why Prosecutors Escape Punishment*”.
- 27 Bagaric, Mirko, Clarke, Julie, Rininger, William, *Plea Bargaining: From Patent Unfairness to Transparent Justice*, faqe 22-23.

marrëveshjeje për pranimin e fajësisë²⁸ sugjerojnë fuqishëm që të pandehurit e pafajshëm mund të detyrohen (ose mund të themi “shtrëngohen”) të pranojnë fajin për të shmangur gjyqin me një rezultat të pasigurt (që nëse shpallen fajtorë, patjetër që rezultati është më i keq). Me interes të veçantë në këtë drejtim janë rastet kur të pandehurit, nëse nuk bien dakord të pranojnë fajësinë, rrezikojnë të bëjnë dënime shumë të rënda siç është dënimi kapital. Deri në ç’masë mund të argumentohet se një i pandehur i cili po përballet me një dënim kapital dhe më pas pajtohet të pranojë fajësinë në këmbim të dënimit kapital që do të kthehet në një dënim me burgim të përjetshëm, ka hequr dorë me dashje dhe me inteligjencë nga e drejta e tij për një gjykim? Pyetja është interesante sepse në fakt heqja dorë është në të vërtetë inteligjente: i pandehuri e di se çfarë po rrezikon (domethënë të humbasë jetën e tij për shkak të dënimit me vdekje) dhe me arsye zgjedh të keqen më të vogël, domethënë dënimin e gjatë me burgim. Sidoqoftë, çështja qendron se, pikërisht kjo mundësi (e humbjes së jetës së tij / saj) peshon më shumë në mendjen e të pandehurit kur pranon marrëveshjen e fajësisë se çdo gjë tjetër. Shkurt, dhe për të shpëtuar jetën e tij, i pandehuri do të pajtohet me çdo gjë që do të parandalonte vendosjen e dënimit me vdekje. Sidoqoftë, Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara ka konstatuar se edhe në raste të tilla, vetë fakti se i pandehuri po përballet me një dënim kapital nuk është i mjaftueshëm për të zhvleftësuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.²⁹ Të paktën për të nënvizuar se si qasja amerikane nuk është përshtatur për këtë çështje me standardet relevante ndërkombëtare të së drejtës ndërkombëtare, vlen të përmendet se Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (UN HRC) hodhi poshtë një marrëveshjeje për pranimin e fajësisë të kërkuar nga një shtetas australian i arrestuar nga Forcat e SHBA në Afganistan, për akuzat për terrorizëm dhe i arrestuar në kampin e burgut të Guantanamo në Kubë. Sipas kushteve të marrëveshjes së pranimit të fajësisë, kërkuesi u shpall fajtor në këmbim të një pjese të reduktuar të dënimit, pjesë e së cilës do ta shërbente në Australi. Ai më pas kundërshtoi pjesën e dënimit që kishte për të shërbyer në Australi, duke argumentuar se në dritën e shkeljeve të shumta të ashpra procedurale në marrëveshjen e fajësisë, si dhe keqtrajtimin e tij dhe kushtet e ndalimit në Gjirin e Guantanamo, marrëveshja e tij u detyrua në mënyrë efektive; UNHRC-ja e pranoi këtë kundërshtim, duke vënë në dukje se: *“... për të shpëtuar nga shkeljet me të cilat ai ishte ekspozuar, autori nuk kishte zgjidhje tjetër përveçse të pranonte kushtet e marrëveshjes së pranimit të fajësisë që i ishte dhënë”*.³⁰

Në dritën e sa më sipër, me siguri mund të konkludohet se sukcesi i habitshëm i sistemit të negociatave për pranimin e fajësisë së SHBA bëhet në kurriz të të drejtave penale procedurale të të pandehurit. Me të vërtetë, ky sistem në mënyrë efektive dhe me vetëdije sakrifikon të drejtat procedurale penale të të pandehurit për qëllime pothuajse administrative, përkatësisht për të siguruar një trajtim të shpejtë të çështjeve në pritje dhe për të zvogëluar stokun e çështjeve gjyqësore të prapambetura.

28 Fair Trials International, Dorëzimi pranë Zyrës së OKB-së të Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut i raportit mbi zbatimin e dokumentit të UNGASS Outcome mbi problemin botëror të drogës, në lidhje me të drejtat e njeriut, maj 2018, në dispozicion në: <https://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/HRCouncil/DrugProblem/HRC39/FairTrialsSubmission.pdf>, fq 4.

29 *Brady v. United States*, 397 U.S. 742 (1970), e aksesueshme në: <https://supreme.justia.com/cases/federal/us/397/742/>

30 U.N. HRC, Communication No. 2005/2010, *Hicks v. Australia*, 5 Nëntor 2015, CCPR/C/115/D/2005/2010, e aksesueshme në: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CCPR/C/115/D/2005/2010&Lang=en, paragrafi 4.9.

3. Shndërrimi i sistemeve të heqjes dorë nga gjykimi në sisteme funksionale: Arritja e një marrëveshjeje (më) të ndershme

Përfshirja e sistemit të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë, si ai që aplikohet në SHBA dhe dhënia e diskrecionit shtesë prokurorëve, duket se ka keqësuar tashmë problemet ekzistuese në rendet përkatës juridikë, lidhur me respektimin e të drejtave procedurale penale; kështu në Bosnje shumica e të pandehurve që kanë pranuar një marrëveshje fajësie e bënë këtë para se të binin dakord me prokurorin lidhur me dënimin e tyre, ndërsa ata (të pandehurit) as nuk ishin të përfaqësuar nga një avokat.³¹ Përkundër interesimit dhe përkundër kritikave publike të sistemit të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë, prokurorët boshnjakë kanë shprehur kënaqësinë e tyre për efikasitetin e këtij sistemi dhe janë ankuar për “*aktivizmin*” e gjykatave, kur janë hedhur poshtë marrëveshjet për pranimin e fajësisë.³² Në Gjeorgji, kritikët janë shprehur mbi pushtetin e gjerë të prokurorit në kontekstin e marrëveshjes së fajësisë, duke argumentuar se mungesa e standardeve objektive dhe mospërputhja e ka bërë marrëveshjen e pranimit të fajësisë të “... *shfaqet në kuptimin e saj më të keq*”.³³ Prokurorët gjeorgjianë gjithashtu kanë përdorur nxitjen e një dënimi më të ulët për “bindjen” e të pandehurve për të hequr dorë nga avokatët që ata (prokurorët) nuk i pëlqejnë - në të vërtetë, në disa raste është raportuar se emërimi i një avokati të ri (dhe me gjasë më të përpunueshëm nga prokurori) është pjesë e vetë marrëveshjes.³⁴ Në Maqedoninë e Veriut, mungesa e transparencës rreth marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë është përdorur për të mbyllur çështjet e ndjeshme politike, ndërsa prokurorët (dhe gjyqtarët) kanë përdorur paraburgimin si një mjet presioni në negociata me qëllim që të nxisnin të pandehurit të nisin bisedimet për një marrëveshje për pranimin e fajësisë.³⁵ Ndërsa disa nga problemet e hasura në këto vende janë korrigjuar, përvojat e tyre me mënyrën amerikane të marrëveshjes për pranimin e fajit ende shërbejnë si fabula paralajmëruese.

A duhet që sa më lart të nënkuptojë se sistemet e marrëveshjeve për pranimin e fajësisë në veçanti dhe sistemet e heqjes dorë nga gjykimi në përgjithësi janë strukturalisht në kundërshtim me të drejtat procedurale penale të të pandehurit?

Përgjigjja është jo. Për mirë ose për keq, sistemet e heqjes dorë nga gjykimi do të mbeten një tipar i shumicës së sistemeve ligjore për shkak të përparësive që ato ofrojnë në drejtim të menaxhimit të burimeve të pakta në dispozicion të organeve të drejtësisë. Si rezultat, pyetja duhet të jetë se si mund të bëhen më të barabarta dhe të ndershme sistemet e heqjes dorë nga gjykimi. Është vënë re se defekti më i madh i sistemeve të heqjes dorë sipas stilit amerikan është pikërisht dhënia e një diskrecioni pothuajse të shpenguar prokurorit. Kjo, së bashku me pozitën dominuese që ai gëzon gjatë bisedimeve për marrëveshjen e fajësisë, çon në një

31 Alkon, Cynthia, *Plea Bargaining as a Legal Transplant: A Good Idea for Troubled Criminal Justice Systems*, faqe 372 – 373.

32 Po aty, faqet 376 – 377. Në 2015, përqindja ra në 41%; shih Fair Trials International, *The Disappearing Trial: Towards a rights-based approach to trial Waiver systems*, faqe 34.

33 Cituar nga Transparency International, *Plea Bargaining in Georgia: Negotiated Justice*, 2010, e aksesueshme në:
https://www.transparency.ge/sites/default/files/post_attachments/Plea%20Bargaining%20in%20Georgia%20-%20Negotiated%20Justice.pdf,
faqe 17.

34 Po aty, faqe 18.

35 Shih raportin e *The former Yugoslav Republic of Macedonia: Recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues relating to the communications interception revealed in Spring 2015 (the "Pribe Report")*, 2015, e aksesueshme në:
https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/nees/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf,
faqet 11, 13.

shtrembërim pothuajse automatik të procedimeve kundër të pandehurit. Thënë thjesht, nuk mund të presësh një pazar të drejtë në një rast se njëra palë nuk ka asgjë për të humbur dhe tjetra ka gjithçka për të humbur nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje.

Është interesante në këtë drejtim të theksohet se pavarësisht nga përfshirja e një forme të marrëveshjes së fajësisë (*patteggiamento sulla pena*), zakonisht i referuar shkurt si *patteggiamento*, legjislatori italian qendroi i kujdesshëm ndaj diskrecionit të prokurorisë dhe kërkoi ta kufizonte atë sa më shumë që të ishte e mundur; kështu që *patteggiamento* nuk shtrihet te marrëveshja për akuzat (dmth., prokurori nuk mund ta zëvendësojë një vepër penale me një tjetër më të butë) ose marrëveshjen për dënimin (duke e përcaktuar në ligj përfitimin, konkretisht duke ulur një të tretën e dënimit). Për më tepër, i pandehuri ka të drejtë të kundërshtojë refuzimin e prokurorit për të nisur bisedimet për një *patteggiamento* dhe prokurori duhet të japë arsye për refuzimin e tij. Dështimi për ta bërë këtë mund ta çojë gjykatën që ta shmangë prokurorin dhe të vendosë vetë zvogëlimin e dënimit.³⁶ Në të vërtetë, numri i ulët i *patteggiamento*-ve të arritura nga prokurorët italianë u është atribuar, ndër të tjera, mungesës së stimujve për prokurorët për të disponuar mbi çështjet përpara se ato të shkojnë në gjykatë.³⁷

Duke pasur parasysh gjetjet e mësipërme, si dhe vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastet e negociimit të marrëveshjes të fajësisë³⁸, masat mbrojtëse në vijim duhet të krijohen³⁹ me qëllim nivelimin e fushës së lojës për sistemet e heqjes dorë nga gjykimi; siç do të shihet, këto masa mbrojtëse (p.sh. ndihma juridike efektive, qasja në kohë dhe lehtësitë e përshtatshme për të ngritur një mbrojtje efektive) duhet të jenë po aq të zbatueshme për praktikisht të gjitha format e procedimeve penale. Kjo, nga ana tjetër, do të thotë që sistemet e heqjes dorë nga gjykimi nuk duhet të konsiderohen si një mekanizëm për të anashkaluar masat mbrojtëse procedurale të zakonshme, por duhet të jenë të pajisura me një nivel të barabartë mbrojtjeje procedurale ndaj asaj që është e mundur për të pandehurit në procedurat e zakonshme penale.

36 Pizzi, William T, *The New Italian Code of Criminal Procedure: The Difficulties of Building an Adversarial Trial System on a Civil Law Foundation*, Volume 17, Issue 1, Yale Journal of International Law, 1992, e aksesueshme në: <https://digitalcommons.law.yale.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1585&context=yjil>, faqet 11, 22.

Shih gjithashtu Frommann, Maike, *Regulating Plea-Bargaining in Germany: Can the Italian Approach Serve as a Model to Guarantee the Independence of German Judges?*, faqet 214 - 217.

37 Luparia Luca, Gialuz Mitja, *Italian Criminal Procedure: Thirty Years After the Great Reform*, faqet 66-67.

38 Shih gjithashtu *Leuska and Others v. Estonia*, nr. 64734/11, 7 Nëntor 2017, *Litwin v. Germany*, nr. 29090/06, 3 Nëntor 2011, *Dimitrova and Others v. Bulgaria*, nr. 44862/04, 27 Janar 2011, *Kwiatkowska c. Italie* (dec), nr. 52868/99, 30 Nëntor 2000, *Gray v. Germany*, nr. 49278/09, 22 Maj 2014. Duhet të theksohet se në disa prej këtyre rasteve Gjykata ka kritikuar dështimin e ligjit vendas për të siguruar një pjesëmarrje kuptimplotë të viktimës / familjes së saj në procedurën penale kundër të pandehurit që zgjodhi procedurën e heqjes dorë nga gjykimi. Megjithatë, çështja e të drejtave të viktimave në raste të tilla del jashtë qëllimit të këtij materiali.

39 Garancitë e mëtejshme janë të ndikuara fuqishëm nga rekomandimet e Fair Trials International, në raportin: *The Disappearing Trial: Towards a rights-based approach to trial Waiver systems*, faqet 52 – 57, nga Rekomandimi R(87)18 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, për Thjeshtimin e Drejtësisë Penale, e aksesueshme në:

https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016804e19f8

dhe raporti i Komitetit për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut të Asamblesë Evropiane të Këshillit të Evropës (PACE) *Deal-making in criminal proceedings: the need for minimum standards for trial waiver systems*, AS/Jur (2018)/37, si dhe Rezoluta e PACE 2245/208; dy dokumentet e fundit mund të aksesohen në:

<http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-DocDetails-EN.asp?FileID=25041&Lang=EN>

Së pari, të pandehurit duhet të kenë akses të detyrueshëm në përfaqësimin ligjor në kontekstin e përdorimit të mekanizmave të heqjes dorë nga gjykimi. Në të njëjtën kohë, dhe siç është edhe rasti me procedimet penale në përgjithësi, ky përfaqësim ligjor duhet të jetë efektiv; avokatët - edhe ata të caktuar kryesisht - duhet të trajtohen dhe të paguhën në mënyrë të përshtatshme. Përfaqësimi ligjor në nivelin e duhur mund të çojë në një refuzim të mëvonshëm të pranimit të marrëveshjes së fajësisë, siç është pranuar kohët e fundit edhe nga Gjykata Supreme e SHBA-së në çështjen *Lee kundër Shteteve të Bashkuara*, në të cilën Gjykata Supreme konstatoi se “arsyeja përcaktuese” pse z. Lee kishte pranuar një marrëveshje fajësie ishte premtimi (i gabuar) i bërë atij nga avokati i tij se në këtë mënyrë ai nuk do të dëbohej nga SHBA. Po ta kishte ditur se marrëveshja e pranimit të fajësisë nuk mund ta pengonte dëbimin e tij, atëherë është e arsyeshme të supozohet se ai do të kishte zgjedhur dërgimin e çështjes në gjyq, pasi vetëm në këtë mënyrë do të kishte një shans për të mos u dëbuar - pavarësisht pasojave të tjera negative që mund të sillte gjykimi (p.sh. duke pësuar një dënim me burgim më të gjatë).⁴⁰

Së dyti, dhe lidhur me masat mbrojtëse të përmendura në pikën e mësipërme, avokatëve duhet t’u sigurohet kohë dhe lehtësira të mjaftueshme, si dhe akses në dosjen e çështjes me qëllim ndihmën e të pandehurit që ai të marrë një vendim të informuar nëse marrëveshja për pranimin e fajësisë sjell përfitim për të. Kjo nga ana tjetër kërkon që çdo marrëveshje të mos arrihet menjëherë pas akuzës / arrestimit të të pandehurit (në momentin kur policia dhe autoritetet e prokurorisë nuk kanë shfrytëzuar ende shumë kohë për të mbledhur prova të konsiderueshme kundër tij), por të bëhet në një fazë të mëvonshme; ekzistenca e një prove të fortë (edhe pse jo domosdoshmërisht e mjaftueshme për një dënim) kundër të pandehurit do të zbuste gjithashtu çdo frikë që publiku mund të ketë në trajtimin preferencial të disa kategorive të të pandehurve ndaj të tjerëve. Sa më sipër përfshin edhe mospërdorimin e stimujve për të nxitur marrëveshjen për pranimin e fajësisë gjatë fazës së hetimit paraprak, pasi nëse stimujt përdoren gjatë fazave shumë të hershme të hetimit, atëherë të pandehurit mund të ndihen të detyruar të lidhin menjëherë marrëveshjen, pavarësisht nëse mund të jenë të pafajshëm. Kështu, për shembull, sipas modelit australian të pranimit të fajësisë, i pandehuri ka të drejtë të përfitojë uljen e dënimit pas lidhjes së një marrëveshje fajësie në çdo moment gjatë procedimeve kundër tij; megjithëse sa më herët bëhet pranimi i fajësisë, aq më e madhe është ulja e dënimit.⁴¹ Në mënyrë të ngjashme, nuk duhet të ketë përfitime të konsiderueshme të pabalancuara në rastin e pranimit të fajësisë dhe pasojave negative për zgjedhjen e një gjykimi të rregullt, pasi sa e më e madhe është kjo pabarazi, aq më shumë gjasa ka që i pandehuri të jetë në mënyrë efektive i shtrenguar për t’u pajtuar me heqjen dorë nga gjykimi.

Së treti, duhet të sigurohet një shqyrtim efektiv gjyqësor i aspekteve kryesore të çdo çështjeje të trajtuar me mekanizmin e heqjes dorë nga gjykimi, në veçanti të natyrës së vërtetë vullnetare të marrëveshjes nga ana e të pandehurit, për përshtatshmërinë e dënimit të propozuar (në mënyrë që të adresojë mundësinë e përdorimit të mbindëshkimit nga ana e prokurorit), të efektivitetit dhe përshtatshmërisë së ndihmës juridike që i është dhënë të pandehurit, si dhe të mjaftueshmërisë *prima facie* të provave kundër të pandehurit (kjo e fundit tashmë është element kyç në rastin e heqjes dorë nga gjykimi në procedura të tjera si gjykimi i shkurtuar). Ndërsa në disa sisteme të heqjes dorë nga gjykimi gjyqtarët kanë një rol për të luajtur edhe në kontekstin e negociatave (si ndërmjetës midis të pandehurve dhe prokurorëve ose duke pyetur për mundësinë e heqjes dorë nga gjykimi pas fillimit të gjykimit), thuhet se në dritën

40 *Lee v United States*, 582 U.S. (2017), e aksesueshme në: <https://supreme.justia.com/cases/federal/us/582/16-327/>

41 Bagaric, Mirko, Clarke, Julie, Rininger, William, *Plea Bargaining: From Patent Unfairness to Transparent Justice*, faqet 22 – 25.

e shqetësimeve që janë shprehur qoftë nga studiuesit ligjorë⁴² dhe organet, siç është Zyra e Institucioneve Demokratike dhe të Drejtave të Njeriut e OSBE-së dhe Komisioni i Venecias⁴³, gjyqtarët nuk duhet të përfshihen direkt në negociata të tilla, pasi përfshirja e tyre mund të konsiderohet si vënie në pikëpyetje e paanshmërisë objektive të tyre.

Së katërtri, ndërsa sipas përkufizimit heqja dorë nga gjyqi nënkupton heqjen dorë nga disa të drejta procedurale, është thelbësore që të sigurohet e drejta për t'u ankuar, të paktën për kufizimin e një të drejte (p.sh. për çështje të ligjit), konkretisht në lidhje me vendimet e nxjerra pas marrëveshjes së heqjes dorë nga gjykimi, për të siguruar një mundësi shtesë të rishikimit të qasjes dhe praktikës së gjykatave më të ulëta në këto procedura.

Së pesti, duhet të shihen mundësitë nëse sistemet e heqjes dorë nga gjykimi duhet të jenë në dispozicion në lidhje me të gjitha kategoritë e veprave penale ose vetëm për disa prej tyre (p.sh. vetëm vepra të të dënueshme me një sasi të kufizuar burgimi). Në mënyrë ideale, heqja dorë nga gjykimi duhet të lejohet vetëm për ato vepra penale që përmbajnë dënime të ulëta ose të mesme, pasi për veprat penale me dënim shumë të lartë, heqja dorë nga gjykimi mund të shërbejë si nxitje për të pandehurin për të shmangur një gjykim të zgjatur dhe rezultatin e pasigurt.⁴⁴ Në çdo rast, dhe pavarësisht nga vendimi i ligjvënësit lidhur me atë se cilat kategori të veprave penale duhet t'i nënshtrohen heqjes dorë nga gjykimi, ajo që është e rëndësishme është që disponueshmëria e këtyre procedurave të jetë automatike dhe jo në varësi të diskrecionit të prokurorit.

42 Frommann, Maike, *Regulating Plea-Bargaining in Germany: Can the Italian Approach Serve as a Model to Guarantee the Independence of German Judges?*, faqet 205 – 208.

43 Opinioni i Përbashkët i OSBE/ODIHR – Komisioni i Venecias për Kodin e Procedurës Penale të Gjeorgjisë, Opinioni nr. CRIM-GEO/257/2014[RJU], 2014, i aksesueshëm në: <https://www.osce.org/odihr/124229>, faqe 12, paragrafi 23.

44 Po aty, faqe 11, paragrafi 21.

IV. GJYKIMI ME MARRËVESHJE FAJËSIE SIPAS LEGJISLACIONIT VENDAS

1. Gjykimi me marrëveshje, risi për drejtësinë penale shqiptare

Gjykimi me marrëveshje përbën një risi për legjislacionin shqiptar. Ky institut u parashikua për herë të parë në Kodin e Procedurës Penale, në vitin 2017. Më parë, ky lloj gjykimi nuk parashikohej në legjislacionin procedural penal.

Në kuadër të reformës në drejtësi (me ligjin 35/2017), Kodi i Procedurës Penale pësoi ndryshime në një pjesë të konsiderueshme të dispozitave të tij. Nevoja për një reformim të drejtësisë penale, për shkak të problemeve që dilnin gjatë proceseve, me vonesat apo mungesën e efikasitet nga ana e prokurorëve, apo nevoja për përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë evropian, në kuadër të procesit të anëtarimit në BE, solli një sërë ndryshimesh në Kodin e Procedurës Penale. Këto ndryshime nuk konsistojnë thjesht dhe vetëm në ndryshimin e dispozitave ekzistuese, por gjithashtu Kodi u pasurua me institute të reja, të parregulluara më parë. Një nga këto risi është edhe gjykimi me marrëveshje, një formë e re e gjykimeve të posaçme, që gjen një rregullim në nenet 406/d e vijues të Kodit.

2. Avantazhet dhe disavantazhet

Kjo praktikë e re gjyqësore, e servitur nga ana e legjislatorit, shihet në interes të të dy palëve, të përfshira në këtë proces. Nga njëra anë, i pandehuri vendoset në një pozitë më të mirë, pasi i jepet mundësia të marrë një dënim më të favorshëm, sesa ai që do të jepej, nëse do të dilte fajtor mes një gjykimi të zakonshëm. Nga ana tjetër, kjo i kursen kohë prokurorit që disa çështje t'i mbyllë në një kohë të shkurtër, duke i hapur rrugë zhvillimit të hetimeve për çështje të tjera penale duke sjellë rritje të efektivitetit të punës së prokurorit.

Gjithashtu, ky lloj gjykimi i shërben ekonomisë gjyqësore, pasi sjell një reduktim të shpenzimeve gjyqësore, duke qenë se mund të propozohet si gjatë hetimeve paraprake, ashtu edhe gjatë seancës paraprake dhe sjell për pasojë heqjen dorë nga zhvillimi i debatit gjyqësor midis palëve. Në çdo rast arritja e marrëveshjes midis palëve eviton gjykimin në apel, pasi duke qenë se vendimi i gjykatës është marrë mbi bazën e pëlqimit (konsensual) midis palëve, atëherë nuk ka logjikë që të ushtrohet ankimi.⁴⁵

Megjithatë, jo gjithmonë gjykimi me marrëveshje është një zgjidhje e favorshme, të paktën për të pandehurin. Kjo pasi, nuk mund të thuhet me siguri nëse përfitimi i të pandehurit nga pranimi i marrëveshjes së ofruar nga prokurori dhe heqjes dorë nga gjykimi do të jetë në çdo rast më i favorshëm sesa përfitimi që mund të kishte ai, nëse do zhvillohej gjykimi. Ajo që mund të themi për marrëveshjen e fajësisë është se i pandehuri do të marrë në çdo rast një dënim. Nënshkrimi i saj nënkupton pranim fajësie dhe marrjen e një dënimi të caktuar, ndërsa mospranimi i saj do të çonte çështjen në gjykim, përmes të cilit teorikisht pritet të ketë dy rezultate; (1) deklarimi fajtor dhe dhënia e një dënimi me gjasa më të rëndë se ai i ofruar përmes marrëveshjes dhe; (2) deklarimi i pafajësisë.

Shmangia nga gjykimi i rregullt i çështjes, thënë ndryshe, shmangia nga gjykimi, sjell për të pandehurin heqje dorë nga disa të drejta procedurale, për këtë arsye kjo duhet të kompensohet me një kujdes të veçantë, në cilësinë e ndihmës juridike në fazën e lidhjes së marrëveshjes. Mbrojtësi, i zgjedhur apo i caktuar nga gjykata, duhet të ndihmojë të pandehurin që të bëjë zgjedhjen e duhur, duke i bërë të gjitha përpjekjet për të parë mundësinë që të zhvillojë gjykimin dhe të marrë një rezultat shumë më të favorshëm, që mund të jetë edhe pafajësia.

Në këtë kuptim ofrimi i një mbrojtjeje efektive, gjatë gjithë praktikës së marrëveshjes së fajësisë, nisur që në fazën e lidhjes së marrëveshjes, ashtu edhe gjatë shqyrtimit të saj në nga gjykata, ku mund të kundërshtohet ose hiqet dorë prej saj, është e domosdoshme.

3. Rolet e aktorëve kryesorë në marrëveshjet e pranimit të fajësisë

3.1. Roli i prokurorit

Siç e theksuam më lart, mundësia e zgjidhjes së çështjes me marrëveshje është një nga kompetencat e reja të prokurorit⁴⁶. Në këto praktika çështja nuk ka nevojë të gjykohej në themel nga gjykata, por mundet që prokurori ta zgjidhë atë, paraprakisht me të pandehurin, jashtë sallës së gjyqit, duke rënë dakort për pranimin e fajësisë dhe llojin e dënimit. Ajo që i mbetet gjykatës është shqyrtimi formal i marrëveshjes, duke parë nëse përmbushen kriteret e përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale.

Pra në këtë lloj gjykimi të posaçëm, rolet e prokurorit dhe gjykatës në procesin penal ndryshojnë. Prokurori fiton kompetenca të reja kundrejt gjykatës, pasi tashmë, fajësia nuk ka nevojë të vërtetohet përmes gjykimit të zakonshëm, por mjafton pohimi i fajësisë nga i pandehuri, para prokurorit.⁴⁷ E thënë ndryshe, të pandehurit dhe prokurorit i jepet një mundësi negociimi për fatin e çështjes, me kushtin që i pandehuri të dalë fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet dhe prokurori në shkëmbim i propozon atij, një masë dënimi më të ulët se ajo që do merrte nëse do të provohej fajësia përmes gjykimit të rregullt. Masa

45 Vendimi nr. 552, datë 27.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, *Prokuroria k. E.S.*

46 Neni 24/4 Kodi i Procedurës Penale së Shqipërisë.

47 Kodi i Procedurës Penale kërkon që ky pohim të bëhet vetëm përpara prokurorit dhe jo para gjykatës.

e dënimit, sidoqoftë duhet të jetë e tillë që të përshtatet me rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe të bindë të pandehurin, që çështja mos të ndjekë rrugën e zakonshme të gjyqimit. Gjykimi me marrëveshje gjen rregullim në nenet 406/d e vijues të Kodit të Procedurës Penale, në kapitullin e gjykimeve të posaçme. Në nenin 406/d të KPP, janë parashikuar në mënyrë të qartë elementët formale që duhet të përmbajë “Marrëveshja mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit”.⁴⁸

- Së pari, marrëveshja propozohet nga prokurori, i pandehuri ose përfaqësuesi i tij i posaçëm. Hapësira për propozimin e marrëveshjes jo vetëm nga prokurori, shihet si një moment pozitiv, pasi kufizon kompetencat e prokurorit në këtë aspekt. Por Kodi nuk shprehet për detyrimin e prokurorit për nisjen e procedurës së lidhjes së marrëveshjes, në rastin kur marrëveshjen e propozon i pandehuri. Ajo që thuhet në ligj dhe me të drejtë është se marrëveshja arrihet me pëlqimin e ndërsjelltë të palëve. Kjo do të thotë që prokurori njësoj si I pandehuri nuk është i detyruar kundrejt propozimit të palës tjetër. Nga ana tjetër, prokurorit nuk i njihet e drejta për t’u tërhequr nga marrëveshja, e drejtë e cila i atribuohet të pandehurit shprehimisht. Ky i fundit ka të drejtë që pëlqimin për marrëveshjen t’u tërheqë në çdo rast, para se gjykata të marrë një vendim në lidhje me pranimin ose jo të marrëveshjes. Gjithashtu nuk parashikohet detyrimi i prokurorit për të dhënë një vendim të arsyetuar në rastet e refuzimit të marrëveshjes.

Jemi të mendimit që do të ishte e drejtë të kërkohej marrja e një vendimi të arsyetuar për refuzimin e marrëveshjes nga ana e prokurorit, me qëllim kufizimin e pushtetit të prokurorit. Kujtojmë se këto lloj gjykimesh njihen për peshën dhe pushtetin e dhënë prokurorit.

- Së dyti, elementi tjetër i gjykimeve me marrëveshje është momenti i lidhjes së marrëveshjes. Kodi lë një hapësirë relativisht të gjerë për lidhjen e marrëveshjes, duke nisur që nga çasti i regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale, derisa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor. Kjo është faza procedurale në të cilën mund të propozohet lidhja e një marrëveshje dhe brenda së cilës prokurori duhet të paraqesë kërkesën në gjykatë për miratimin e saj. Shqyrtimi gjyqësor çelet nga kryetari i seancës, pasi janë kryer një sërë veprimesh paraprake⁴⁹. Pra që nga momenti i regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale, deri përpara se gjyqtari ta marrë në shqyrtim themelin e çështjes, palët mund të lidhin një marrëveshje. Jemi të mendimit që negocimi i marrëveshjes së fajësisë të mos bëhet që në fazat e hershme të hetimit, por të paktën kur prokurori të ketë siguruar materiale të mjaftueshme për të fajësuar të pandehurin.

Një pyetje që shtrohet për diskutim është se cilit moment procedural i referohet ligjvënësi kur përmend termin *shqyrtim gjyqësor*, për efekt të momentit të fundit kur mund të pranohet kërkesa për marrëveshje? Këtu kemi dy mundësi interpretimi:

Së pari, sipas një interpretimi të ngushtë, palët mund ta kërkojnë arritjen e një marrëveshje në seancën paraprake, ku me seancë paraprake kuptojmë seancën që përcakton nëse çështja do të dërgohet për gjykim ose jo, rregulluar nga kreu IX i Kodit të Procedurës Penale⁵⁰ dhe jo pasi Gjykata ka marrë vendimin për dërgimin e çështjes për gjykim. Kjo mënyrë leximi e ligjit do

48 Vendimi 1421 datë 11.05.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, *Prokuroria k. G.S.*;

49 Neni 355 të K.Pr.Penale: “1. Pasi kryhen veprimet e treguara në nenet e mësipërme, kryetari e deklaron të hapur shqyrtimin gjyqësor dhe tregon identitetin e të pandehurit dhe akuzën në ngarkim të tij.”

50 Neni 332/c/5 të K.Pr.Penale “Zhvillimi i seancës paraprake”: “5. Palët mund të paraqesin marrëveshje mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit...”

të siguronte që marrëveshja të diskutohej si pjesë e veprimeve hetimore, ku garantohet edhe sekreti hetimor, në rastin kur ajo nuk do të miratohej nga gjykata dhe çështja do të ndiqte procedurën e zakonshme të hetimit, me pasojë pushimin apo dërgimin e çështjes në gjykim sipas gjykimit të zakonshëm.

Së dyti, në një interpretim të gjerë, kërkesa për marrëveshje paraqitet në gjykim mjafton që të paraqitet para shqyrtimit gjyqësor, ku me këtë të fundit kuptojmë momentin kur seanca paraprake është mbyllur dhe çështja është dërguar për gjykim. Në këtë rast kërkesa duhet të paraqitet së bashku me kërkesat e tjera paraprake, gjatë veprimeve përgatitore (të parashikuara në nenin 354). Sipas këtij interpretimi ka vend që në kërkesat paraprake të jetë edhe kjo lloj kërkesë, pavarësisht se kërkesat paraprake të parashikuara nga neni 354 nuk e përmbajnë një të tillë. Por, duke interpretuar nenet në tërësi, listimi i kërkesave paraprake në nenin 354 nuk janë shteruese. Mundet që palët të paraqesin në këtë fazë, pra gjatë veprimeve paraprake, para çeljes së shqyrtimit gjyqësor, edhe ato kërkesa që parashikohen në dispozita të tjera të K.Pr.Penale. Shembull është kërkesa për pavlefshmërinë relative të akteve, parashikuar në nenin 129/3⁵¹. Njësoj mund të jetë rasti i paraqitjes së kërkesës për marrëveshje edhe në këtë moment procedural. Për arsyet më sipër, sipas këtij interpretimi, fraza e nenit 406/d *“para shqyrtimit gjyqësor”* përfshin mundësinë e paraqitjes së kërkesës për marrëveshje edhe në gjykim, mjafton të jetë para çeljes së shqyrtimit gjyqësor.

Pyetja e dytë që shtrohet për diskutim është sa është minimumi i dënimit që mund të propozojë prokurori?

Duke qenë se instituti i marrëveshjeve të fajësisë është ende i ri në legjislacionin tonë dhe ende nuk është formuar një praktikë gjyqësore lidhur me të, nuk mund të themi për vështrësitë apo mundësitë e interpretimeve të ndryshme nga gjyqtarët. Gjithsesi do të ishte e rekomandueshme një saktësim i këtyre dispozitave, të cilat në mënyrë alternative do t'i konsolidojë praktika gjyqësore apo doktrina në vijim.

Përpos sa më sipër, i pasaktë paraqitet neni 406/dh, ku thuhet se *në rast se marrëveshja paraqitet në seancë paraprake, gjykata vendos sipas parashikimeve të paragrafit 4, të nenit 332/c, të këtij Kodi*. Ndërkohë që neni 332/c, paragrafi 4 parashikon se:

“Pasi të pandehurit paraqesin pretendimet e tyre viktime dhe palët e tjera private, kur janë të pranishme.”

Duket qartë që këto dy dispozita nuk lidhen me njëra tjetrën. Logjikisht, ajo që ndoshta legjislatori ka dashur të shprehë, është që shqyrtimi i kërkesës për marrëveshjen në seancë paraprake, zhvillohet sipas rregullave të nenit 332/c. Gjithsesi, nuk do të ishte korrekte të supozonim për qëllimin e legjislatorit në këtë rast, ndaj sugjerojmë që ky referim ligjor të shfuqizohet ose ndryshohet sipas rastit.

3.2. Roli i mbrojtësit

Në bisedimet për arritjen e marrëveshjes prania e mbrojtësit të të pandehurit është e detyrueshme. Në rast se gjykata, gjatë seancës së shqyrtimit të marrëveshjes, konstaton se i pandehuri e ka lidhur marrëveshjen pa pasur praninë e një mbrojtësi, e refuzon miratimin e

51 Neni 129/3 i Kodit të Procedurës Penale: *“Pavlefshmëria lidhur me aktet e hetimeve paraprake dhe me ato të kryera për sigurimin e provës duhet të kundërshtohet në seancën paraprake ose në seancë gjyqësore përpara se të fillojë shqyrtimi gjyqësor, sipas nenit 355 të këtij Kodi.”*

saj. Prania e mbrojtësit mund të verifikohet nga gjykata, pasi Kodi kërkon që në mënyrë të detyrueshme marrëveshja të nënshkruhet edhe nga ai. Detyrimi ligjor për të siguruar mbrojtjen të pandehurit gjatë procedurës së gjykimit me marrëveshje është domethënës dhe gjen mbështetjen te nevoja për të siguruar çdo të drejtë të mundshme dhe interesin e të pandehurit, pasi për nga natyra gjykimi me marrëveshje është në vetvete në disfavor të të pandehurit, meqë ky i fundit heq dorë nga gjykimi dhe bashkë me të nga disa të drejta procedurale. Në këtë kontekst duhet siguruar që mbrojtja juridike në këtë procedurë të jetë efektive dhe jo thjesht formale. Në rastin kur avokati është i zgjedhur nga i pandehuri, kjo garanci sigurohet mes tregut të lire. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet avokatëve të caktuar kryesisht, të cilët duhet të jenë të trajnuar dhe mbi të gjitha të motivohen edhe nga pagesa të drejta që të kryejnë me cilësi detyrën e caktuar. Një nga kushtet më thelbësore të marrëveshjes është pohimi i fajësisë së të pandehurit. Gjithashtu kërkohet që pohimi të jetë i plotë dhe jo i pjesshëm, pasi marrëveshja me kusht për pranimin e pjesshëm të akuzave është e papranueshme. Me këtë veprim, i pandehuri heq dorë nga garancia që i ofron parimi i prezumimit të pafajësisë, duke i hequr prokurorit barrën që ka për të provuar fajësinë në gjykim, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Mund të ndodhë që i pandehuri, nga frika apo presioni që mund të ndjejë për shkak të procesit që zhvillohet ndaj tij, të shohë si zgjidhje më të favorshme pohimin e fajësisë dhe lidhjen e marrëveshjes, duke shmangur gjykimin. Si shembull është rasti kur ndaj të pandehurit është dhënë një masë sigurimi. Caktimi i një mase sigurimi nga gjykata, mund të krijojë tek ai ndjenjën e frikës, apo bindjen që do të shpallet i fajshëm në gjykim. Kjo situatë mund të ndikojë që ai të shtyhet drejt pranimit të fajësisë para prokurorit dhe të pranojë dënimin që i propozohet. Në këtë mënyrë ai heq dorë nga disa të drejta që mund ti shfrytëzonte nga zhvillimi i gjykimit. Këtu mund të përmendim heqjen dorë nga garancia që ofron parimi i prezumimit të pafajësisë, heqja dorë nga e drejta për të qendruar në heshtje, apo nga e drejta për t'i drejtuar pyetje dëshmitarëve, ekspertëve apo të pandehurve të tjerë, si dhe çdo të drejtë që do mund të ushtronte po të zhvillohej gjykimi. Pikërisht për shkak të rëndësisë themelore të heqjes dorë nga këto të drejta, të pandehurit duhet t'i garantohet një mbrojtje juridike efektive.

Në rastin kur i pandehuri është i mitur, i pranishëm duhet të jetë edhe psikologu, si në fazën e lidhjes së marrëveshjes, ashtu edhe kur të zhvillohet seanca gjyqësore për miratimin e saj.⁵²

Gjithashtu Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, ka vendosur një kusht që gjykimi me marrëveshje për të miturit të zbatohet vetëm në rastin e zbatimit të masës së shmangies për të miturin në konflikt me ligjin (neni 94 *"Parimet e përgjithshme të dënimit"*).

3.3. Roli i gjykatës

Formalisht marrëveshja e fajësisë bëhet me shkrim dhe duhet të përmbajë me pasojë pavlefshmërie:

- përshkrimin e qartë të faktit penal, për të cilin akuzohet i pandehuri dhe cilësimin e tij juridik;
- deklarin e pohimit të fajësisë nga ana e të pandehurit;
- llojin dhe masën e dënimit penal kryesor, dënimit plotësues, si dhe mënyrën e ekzekutimit të tyre, për të cilat palët kanë rënë dakord;
- disponimet për provat materiale dhe sendet që i përkasin veprës penale, si dhe për konfiskimin e mjeteve e produkteve të veprës penale;
- në rastin kur është legjitimuar paditësi civil, pëlqimin e tij me shkrim për masën e shpërblimit të dëmit nga i pandehuri;

52 Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur kërkon që prania e psikologut për të pandehurin e mitur të jetë në çdo fazë të procesit penal.

- shumën e shpenzimeve procedurale;
- nënshkrimet e palëve dhe të mbrojtësit (edhe psikologut, në rastin i pandehuri është i mitur).

Sa më sipër janë kushtet që vlerëson gjykata para miratimit të marrëveshjes. Kështu pas arritjes së marrëveshjes, prokurori e dërgon atë për miratim në gjykatë, së bashku me të gjitha aktet e hetimeve paraprake.

Gjykata e shqyrton kërkesën për miratimin e marrëveshjes në seancë gjyqësore brenda 30 ditëve nga paraqitja e saj. Kërkesa shqyrtohet në seancë gjyqësore publike, me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar⁵³. Jemi të mendimit se është e gabuar zhvillimi i senacës publike për këtë lloj gjykimi, pasi përfundimi i kësaj seance mund të përfundojë me miratimin e marrëveshjes dhe në këtë rast justifikohet bërja publike e saj, por, nëse kjo rezulton me rrëzimin e marrëveshjes dhe kthimin e çështjes për hetim, do të kishim cenim të procesit dhe të privatësisë së të pandehurit dhe vendosja e tij në pozita të diskriminuara me të pandehurin i cili nuk heq dorë nga gjykimi në këmbim të marrëveshjes së fajësisë.

Sa i takon rolit të gjykatës në këto gjykime, ai nuk duket të jetë thjesht formal. Krahas garantimit të një mbrojtje efektive, siç shpjeguem më sipër, garanci për të pandehurin është edhe vetë gjykata, të cilës i është lënë në kompetencë miratimi i marrëveshjes. Gjatë shqyrtimit të marrëveshjes, përveç elementeve formalë të tillë si përshkrimi i qartë i faktit penal për të cilin akuzohet i pandehuri dhe cilësimi juridik, lloji dhe masa e dënimit, disponimet për provat materiale dhe konfiskimin e mjeteve të produkteve të veprës penale, etj., gjykata vlerëson edhe kushtet thelbësore të marrëveshjes që çojnë në pavlefshmërinë e marrëveshjes ose refuzimin e saj.

Gjykata merr në vlerësim sa më poshtë dhe refuzon marrëveshjen në rast se:

- Provohet se vullneti i të pandehurit ka qenë i vesuar.* Gjykata duhet të tregojë kujdes në vlerësimin nëse vullneti i brendshëm i të pandehurit përputhet me vullnetin e jashtëm të tij, ai që në gjuhën juridike njihet si *vullnet i pavesuar*. I tillë duhet të jetë vullneti i pandikuar nga kanosja, mashtrimi, apo shtrëngimi për rrethana të tjera të ngjashme. Për këtë arsye dhe në këtë fryrë janë miratuar një sërë parashikimesh ligjore. Kështu seanca zhvillohet me praninë e detyrueshme të prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Mosparaqitja pa shkaqe të përligjura të pandehurit dhe mbrojtësit, sjell automatikisht refuzimin e marrëveshjes nga ana e gjykatës. Gjithashtu, gjykata e pyet posaçërisht të pandehurin lidhur me sa më poshtë: (1) nëse e ka bërë marrëveshjen me vullnetin e tij të lirë; (2) nëse ka qenë i përfaqësuar nga mbrojtësi në bisedimet për arritjen dhe nënshkrimin e saj; (3) nëse e kupton marrëveshjen dhe përmbajtjen e saj; (4) nëse i ka kuptuar pasojat që vijnë prej miratimit të marrëveshjes; (5) nëse jep pëlqimin që marrëveshja të miratohet dhe të vihet në ekzekutim.

Mendojmë që gjykata, në rastin e pyetjes së pandehurit në lidhje me marrëveshjen, nuk duhet të mjaftohet thjesht me një pohim të tij që e ka kuptuar përmbajtjen dhe kaq mjafton për ta miratuar atë. Duhet që gjykata të drejtojë një sërë pyetjesh që gjyqtari të krijojë bindjen se i pandehuri e ka kuptuar realisht zgjedhjen e bërë, duke hequr dorë nga gjykimi i çështjes dhe në këtë mënyrë t'i japë mundësinë atij që të reflektojë mbi vendimin e tij.

53 Neni 13/2/f Kodi i Procedurës Penale: *Gjykatat e rretheve gjyqësore gjykojnë me një gjyqtar...çdo kërkesë tjetër të parashikuar në këtë Kod apo në ligje të veçanta.*

- b. *Provat në fashikullin e hetimeve vijnë në kundërshtim me pohimin e të pandeburit se ai e ka kryer veprën penale.* Fakti se i pandehuri ka pohuar fajësinë nuk përbën për gjykatën një shkak determinant për miratimin e marrëveshjes. Gjykata do shikojë të gjitha provat që ndodhen në fashikullin e hetimeve dhe më pas mund të arrijë në përfundimin nëse pohimi i fajësisë përputhet me këto prova, apo këto të fundit e kundërshtojnë atë. Nëse ndodh që provat e kundërshtojnë pohimin e fajësisë, gjykata e refuzon marrëveshjen⁵⁴.
- c. *Cilësimi juridik i veprës penale dhe i rrethanave të kryerjes së saj është i gabuar.* Në këtë rast, nëse gjykata vlerëson se cilësimi juridik i bërë nga prokurori është i gabuar, atëherë vendos refuzimin e marrëveshjes.
- d. *Dënimi i caktuar në marrëveshje është i papërshtatshëm, në raport me veprën e kryer dhe personalitetin e të pandeburit.* Kjo kompetencë dhënë gjykatës, ekuilibron deri diku pushtetin shumë të madh, që i atribuohet prokurorit në këtë procedurë. Megjithatë jemi të mendimit se dhënia e dënimit duhet të mos ishte pjesë e marrëveshjes, por të vendosej nga gjykata. Kjo do të ruante më mirë barazinë e armëve mes palëve dhe do të orientonte dispozitat e procedurës penale drejt sistemit akuzator, sistem i përkrahur nga vendet perëndimore sot. Kodi ynë i Procedurës Penale aplikon sistemin akuzator me elementë të sistemit inkuizitor dhe më të theksuar këto element janë gjatë fazës së hetimeve, ku roli i prokurorit është mbizotërues në kryerjen e hetimeve paraprake.
- e. Një kusht tjetër për vlefshmërinë e marrëveshjes është edhe *dhënia e pëlqimit të paditësit civil, për masën e shpërblimit, në rastin kur ai është legjitimuar.* Ky aspekt ka të bëjë më shumë me anën formale të marrëveshjes, pasi gjykata nuk vlerëson më shumë se sa faktin e paraqitjes së këtij miratimi ose jo.

Ndërsa vihet re se viktimat nuk gëzojnë një të drejtë të tillë, madje edhe pse pas nënshkrimit të marrëveshjes, prokurori ka detyrimin të njoftojë viktimën ose trashëgimtarët e saj, kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, duke i dërguar kopje të saj, nënshkrimi i marrëveshjes nuk varet nga qendrimi i viktimës. I vetmi rol i viktimës në gjykimin me marrëveshje është gjatë shqyrtimit të saj nga gjykata, por edhe në këtë rast viktimat thjesht ftohet të japë një mendim për përmbajtjen e marrëveshjes. Ligji nuk i njeh ndonjë të drejtë viktimës që ta kundërshtojë marrëveshjen, të shprehet për pranimin ose rrëzimin e saj. Jemi të mendimit se të drejtat e viktimës duhet të zgjerohen, përveçse me të drejta të tjera, edhe me të drejta për të dhënë mendimin, kundërshtuar miratimin e marrëveshjes së fajësisë, bazuar në arsyetimin se viktimat është subjekti më i interesuar për një hetim të plotë dhe të gjithanshëm në emër zbardhjes së të vërtetës, kur kjo e fundit nuk ka vlerë vetëm për dënimin e fajtorit por edhe për interesa të drejtësisë. Pikërisht një hetim i plotë dhe i gjithanshëm në këtë kuptim do të ishte ai i bërë përmes procedurave të një gjykimi të zakonshëm.

Gjykata vlerëson aspektet formale dhe thelbësore të marrëveshjes, por nuk mund të ndryshojë kushtet e marrëveshjes së arritur mes palëve.

Por çfarë ndodh në rastin kur marrëveshja miratohet? A ekziston mundësia e revokimit të këtij vendimi? Mund të ndodhë që i pandehuri të kërkojë rishikimin e vendimit të gjykatës që ka miratuar marrëveshjen e fajësisë, me shkakun e daljes së një prove të re, që nëse dihej në kohën e shqyrtimit të marrëveshjes nga gjykata, ajo nuk do e miratonte atë. Të

54 Neni 406/ë pika d: “1. Gjykata vendos të refuzojë miratimin e marrëveshjes kur: ...d) provat në fashikullin e hetimeve vijnë në kundërshtim me pohimin e të pandeburit se ai e ka kryer veprën penale”

gjitha vendimet mund të rishikohen, kështu që mendojmë se edhe vendimet e gjykatës për miratimin e marrëveshjes mund t'i nënshtrohen rishikimit kur paraqiten kushtet.

Gjykata në fund të shqyrtimit të marrëveshjes vendos të miratojë ose refuzojë marrëveshjen. Kur nuk vendos pushimin e çështjes ose kthimin e akteve prokurorit, gjykata vendos miratimin e marrëveshjes. Dispozita parashikon elementët që duhet të përmbajë vendimi i miratimit, me pasojë pavlefshmërie.⁵⁵ Kur është arritur marrëveshja për dëmin civil, ajo është pjesë e përmbajtjes së vendimit gjyqësor.

Në rastin kur gjykata konstaton se ekziston një nga shkaqet e mosfillimit të procedimit ose të pushimit të akuzës ose çështjes gjykata vendos pushimin e çështjes.

Vendimi i gjykatës për refuzimin e miratimit të marrëveshjes duhet të jetë i arsyetuar.

Kur gjykata refuzon miratimin e marrëveshjes, ajo i kthen aktet prokurorit, i cili pas hetimit duhet të ndjekë rregullat normale të gjykimit, duke paraqitur fillimisht kërkesën për dërgimin në gjyq tek gjyqtari i seancës paraprake. Paraqitja e një kërkesë të re për miratim marrëveshje nuk lejohet⁵⁶.

Gjithashtu deklaratimet e të pandehurit gjatë seancës së miratimit të marrëveshjes nuk mund të përdoren kundër tij.

Vendimi i gjykatës që miraton ose refuzon marrëveshjen është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankimi. Duke qënë se refuzohet një marrëveshje e arritur me konsensusin e dy palëve, nuk ka kuptim të ushtrohet ankimi nga i pandehuri. Megjithatë, mendojmë se në raste përjashtimore duhet të ekzistojë e drejta për ankim, në rastet kur janë shkelur të drejta procedurale të domosdoshme në këtë lloj gjykimi, si për shembull mungesa e mbrojtësit, etj. Prokurori mund të bëjë ankim vetëm ndaj vendimit të gjykatës për pushimin e çështjes. Ankimi ndjek rregullat e ankimit për llojet e tjera të vendimeve në gjykimin e zakonshëm.

4. Kufizimet në gjykimet me marrëveshje

Marrëveshja lejohet të kryhet vetëm për ato vepra penale, për të cilat ligji parashikon maksimumin e dënimit 7 vjet, duke u kufizuar bërja e marrëveshjes për vetëm disa vepra penale që nuk kanë rrezikshmëri të lartë shoqërore, gjykuar nga maksimumi i dënimit që mund të jepet. Nga rregulli i mësipërm, ka një përjashtim. Në rastin e bashkëpunëtorit të drejtësisë, kufizimi i masës së dënimit nuk ekziston. Pavarësisht masës së dënimit, midis prokurorit dhe një të pandehuri që ka marrë statusin e bashkëpunëtorit të drejtësisë mund

55 Neni 406/e i Kodit të Procedurës Penale: “Vendimi përmban në mënyrë të përmbledhur, me pasojë pavlefshmërie: a) gjeneralitetet e të pandehurit dhe të dhënat e tjera personale të nevojshme për identifikimin e tij, si dhe gjeneralitetet e viktimës, nëse është e pranishme; b) faktin që i pandehuri ka qënë i përfaqësuar dhe identitetin e mbrojtësit të tij; c) faktin që i pandehuri e ka kuptuar përmbajtjen e marrëveshjes dhe pasojat që vijnë prej saj dhe ka nënshkruar me vullnet të lirë; ç) faktin se cilësimi juridik i veprës dhe rrethanat e saj, përshtatshmëria e dënimit të caktuar, si dhe mungesa e shkaqeve të padënueshmërisë apo të shuarjes së veprës penale, janë vlerësuar drejt nga prokurori; d) deklarinim fajtor të të pandehurit, caktimin e dënimit dhe disponime të tjera, sipas përmbajtjes së marrëveshjes; dh) datën dhe nënshkrimin e vendimit.”

56 Vendimi nr.552, datë 27.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokuroria k. E.S.

të lidhet një marrëveshje.⁵⁷ Fakti që bashkëpunëtori mundet që të lidhë marrëveshje fajësie për çdo veprë penale, pavarësisht masës së dënimit tregon se legjislatori është nisur nga mbrojtja e një interesi të lartë publik që është sigurimi i provave për të hetuar dhe akuzuar të tjerë shtetas, më kryesorë në format e krimit të organizuar. Pikërisht ky interes i lartë i shtetit bën këtë të fundit të ofrojë *shpërblim* mes mundësisë së lidhjes së një marrëveshje me prokurorin për çdo veprë penale, pavarësisht masës së dënimit. Ky është një rast tjetër kur shteti mundësinë e lidhjes së marrëveshjes së fajësisë e përdor si mjet në favorin e tij për të realizuar interesa të tjera më të rëndësishme.

Duke iu kthyer rregullit, modeli i zgjedhur nga legjislatori, që kufizon lidhjen e marrëveshjes së fajësisë në ato vepra penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore është i drejtë në përgjithësi. Por edhe ky model ka dobësitë e veta që qendrojnë në faktin se disa vepra penale, problematike dhe të shpeshta në vendin tone, si shpërdorimi i detyrës, shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike, (këto janë veprat për të cilat kallëzohen nga KLSH më së shumti nëpunësit publik) do të përfshihen në mundësinë e shmangies nga hetimi, duke pranuar marrëveshjen. Në fakt veprat penale të parashikuara në seksionin II të Kodit Penal, i cili i kushtohet veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, parashikojnë një dënim maksimal më të vogël se 7 vjet (përjashtim bën këtu vepra penale e korrupsionit pasiv), e cila nuk zë shumë vend në morinë e veprave penale që mund të ushtrojnë funksionarët publikë. Nëse këtu shtojmë edhe veprat penale ndaj zgjedhjeve të lira (Kreu X i Kodit Penale), apo ato ndaj mjedisit (Kreu IV i Kodit Penal), atëherë gama e veprave të trajtueshme me gjykim me marrëveshje bëhet tepër e madhe dhe diskrecioni i prokurorit për krime që cenojnë rendin demokratik, pasurinë publike, mjedisin ku jetojmë, është vërtet i tepërt. Për këto vepra penale, ndikimi i politikës është më i madh dhe niveli i korrupsionit në organin e hetimit është më i lartë.

Thënë sa më sipër, në një vend me nivel të lartë korrupsioni dhe abuzimi të raportuar si nga organizma kombëtarë apo ndërkombëtarë, ku këto vepra penale janë të shpeshta dhe paraqesin interes të lartë për publikun, do të ishte e rekomandueshme që politikat penale të orientoheshin drejt gjykimeve të zakonshme për këto vepra. Kjo do të shmangte cenimin e besueshmërisë së publikut tek drejtësia. Si shembull sjellim veprën penale të parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”. Nëse një zyrtar i lartë shpallet fajtor për veprën penale të korrupsionit aktiv, por me gjykimin me marrëveshje atij i jepet një nga format alternative të dënimit me burgim, të parashikuara në kreun e shtatë të Kodit Penal, kjo mund të mos pritët mirë nga ana e publikut, për shkak të ndjeshmërisë së lartë të tij për këto vepra dhe gjithashtu do të sillte si pasojë edhe mos zbardhjen e të vërtetës, e cila ka vlerë për efekt të interesave të drejtësisë.

Megjithatë zgjidhja që marrëveshja të jetë e lejueshme vetëm për një kategori veprash me rrezikshmëri të ulët është një zgjidhje optimale, krahasuar me modelin e atyre vendeve që nuk vendosin kufizim për sa i përket masës së dënimit tek vepra penale, gjë e cila do sillte me të drejtë kundërshtim dhe mosbesim të ekspertëve të fushës ligjore, qofshin juristë, avokatë, apo përfaqësues të pushtetit gjyqësor.

57 Figura e bashkëpunëtorit të drejtësisë rregullohet në nenin 37/a të K.Pr.Penale. Në këtë dispozitë, përcaktohet se statusin e bashkëpunëtorit mund ta fitojë një i pandehur që ka kryer një krim që dënohet në maksimum jo më pak se 7 vjet burgim, të kryer në bashkëpunim apo një nga veprat penale që parashikohet në shkronjën “a”, të paragrafit 1 të nenit 75/a të K.Pr.Penale. Ndërkohë që në nenin 37/b pika d), thuhet që marrëveshja për bashkëpunëtorin e drejtësisë duhet të përmbajë edhe të drejtën e bashkëpunëtorit për të kërkuar lidhjen e një marrëveshje për fajësinë sipas nenit 406/e vijues të Kodit.

Në përfundim dhe si konkluzion mund të themi se gjykimi me marrëveshje paraqet një sërë problematikash dhe për praktikën gjyqësore do jetë e vështirë përshtatja e këtij lloj modeli, duke qenë se përbën edhe një risi për të.

V. TË DHËNA NGA STUDIMI I GJYKIMEVE ME MARRËVESHJE TË FAJËSISË NË PRAKTIKË


Siç shpjeguar në metodologjinë, me qëllim vlerësimin e ndihmës juridike falas në proceset e gjykimeve me marrëveshje, u monitoruan gjykimet e këtij lloji për vitin 2018 dhe 4 mujorin e parë të vitit 2019, ku u matën disa parametra me rezultatet si më poshtë, duke u fokusuar te rëndësia/vendi që zënë këto lloje gjykimesh në procesin penal dhe rezultatet e këtyre gjykimeve të bëra me mbrojtjen e avokatëve të caktuar kryesisht dhe gjykimeve të bëra me mbrojtjen e avokatëve të zgjedhur nga vetë të pandehurit.

1. Si paraqitet raporti i çështjeve të cilat eventualisht mund të gjykohen me marrëveshje me çështjet që eventualisht mund të gjykohen me procedurë të zakonshme?

Në statistikën e publikuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë jepen të dhëna për numrin e gjykimeve dhe llojin e veprave penale të gjykuara. Jo të gjitha veprat penale të gjykuara gjatë këtij viti mund të zgjidhen me marrëveshje, për shkak të kufizimit që i bën ligji këtyre gjykimeve të cilat lejohen vetëm për veprat penale, për të cilat sanksionohet një maksimum dënimi jo më i lartë se 7 vjet.

Duke marrë në konsideratë numrin e veprave penale për të cilat mund të lidhet marrëveshje fajësie, në grafikun më poshtë jepet raporti midis numrit të gjykimeve të zakonshme dhe atyre që potencialisht mund të ishin zgjidhur me marrëveshje fajësie.

Fig. 1 - Raporti i çështjeve që mund të zgjidhen me marrëveshje fajësie në krahasim me ato ku ky lloj gjykimi nuk mund të zbatohet



Nga të dhënat në këtë grafik vihet re se 70 % e çështjeve mund të ishin gjykuar me marrëveshje fajësie, gjatë vitit 2018. Me fjalë të tjera, efekti i ekonomizimit të burimeve të hetimeve gjatë vitit 2018 mund të ishte shumë i konsiderueshëm, nëse do të veprimej si në SHBA, ose vende të tjerë ku zbatohet gjerësisht sistemi i heqjes dorë nga gjykimi.

2. Si paraqitet raporti i çështjeve të gjykuara me marrëveshje në praktikë, në krahasim me të gjitha çështjet që mund të ishin gjykuar me marrëveshje fajësie gjatë vitit 2018?

Nga statistikatat e publikuara në faqen e Gjykatës së Tiranës janë përpunuar të dhënat për të nxjerrë numrin e veprave penale, të cilat teorikisht mund të gjykoen me marrëveshje. Këto të dhëna janë krahasuar me të dhënat e monitorimit mbi gjykimin me marrëveshje që janë zhvilluar në praktikë gjatë vitit 2018 dhe vlerat jepen në grafikun në vijim:

Fig. 2 - Raporti i gjykimeve me marrëveshje të zhvilluara në praktikë në krahasim me ato që potencialisht mund të zhvilloheshin me këtë procedurë



Nga statistikatat e publikuara në faqen online të Gjykatës së Tiranës⁵⁸ rezulton se numri i çështjeve të gjykuara gjithsej gjatë vitit 2018 është 4297, nga të cilat 2999 çështje mund të gjykoeshin

me marrëveshje, ndërsa vetëm 359 të tilla janë gjykuar me marrëveshje ose 12 % e potencialit të përgjithshëm. Siç duket, numri i gjykimeve me marrëveshje në praktikë është shumë i vogël, krahasuar me numrin e përgjithshëm të gjykimeve që mund të ishin bërë eventualisht me marrëveshje. Do të ishte e natyrshme të supozonim se ky numër është ende i vogël për shkak se kjo lloj procedure është në hapat e parë të praktikimit në jurisprudencën tonë, por nga të dhënat që jepen në grafikun më poshtë (Fig. 9) rezulton se ky numër është në rënie gjatë vitit 2019, duke na bërë të mendojmë se këto lloj gjykimesh në praktikën tonë gjyqësore janë gjithnjë e më pak të preferueshëm. Gjithsesi duhet thënë se është ende herët për të dalë në përfundime lidhur me rëndësinë dhe vendin që zënë këto lloj gjykimesh në praktikën tonë.

3. Llojet e veprave penale për të cilat është arritur marrëveshje fajësie

Nga monitorimi i gjykimeve të bëra gjatë vitit 2018 ka rezultuar se gjatë këtij viti janë gjykuar 197 figura të veprës penale, 156 prej të cilave mund të gjykoreshin me marrëveshje. Për të parë se cilat janë veprat penale të gjykuara më shpesh mes atyre për të cilat mund të lidhet marrëveshje në tabelën më poshtë kemi veçuar 15 figurat e veprës penale më të shpesh gjykuara me këtë procedurë.

Fig. 3 - Figurat e veprës penale më shumë të gjykuara

| Figurat e veprës penale sipas neneve të K.Penal | Numri i gjykimeve në total |
|---|----------------------------|
| Neni 291 – Drejtimi i automjetit në gjendje të dehur | 1296 |
| Neni 130/a – Dhuna në familje | 394 |
| Neni 134/1 – Vjedhja | 304 |
| Neni 137/1 – Vjedhja e energjisë elektrike | 166 |
| Neni 199/a/1 – Ndërtimi i paligjshëm | 144 |
| Neni 283/1 – Prodhimi / shitja e lëndëve narkotike | 142 |
| Neni 143/1 – Mashtrimi | 110 |
| Neni 242 – Mosbindja ndaj urdhërit të policisë | 82 |
| Neni 89 – Plagosje e lehtë me dashje | 78 |
| Neni 290/2 – Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor | 62 |
| Neni 189/2 – Falsifikimi i pasaportave... | 55 |
| Neni 145 – Mashtrimi në sigurime | 53 |

Nga të dhënat e tabelës rezulton se vepra penale më e shpeshtë e gjykuar është ajo e drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt, (neni 291, Kodi Penal), e pasuar me dhunën në familje (neni 130/a, Kodi Penal), ndjekur nga vjedhja (neni 134, Kodi Penal), dhe vjedhja e energjisë elektrike (neni 137, Kodi Penal), e pasuar me ndërtimin e paligjshëm (neni 199/a/1, Kodi Penal). Për këto vepra potencialisht mund të lidhet marrëveshje, pasi parashikojnë një dënim maksimal më të ulët se 7 vjet.

Nisur nga besimi që marrëveshjet e fajësisë janë një instrument kompromisi për të ekonomizuar procedurat hetimore dhe gjyqësore, me qëllim për të vlerësuar nëse kriteri bazë për lidhjen e marrëveshjeve ka qenë sasia e madhe e çështjeve që hetohen nga prokuroria për një vepër penale, analizuam se për cilat vepra penale lidhet më shpesh marrëveshje dhe a ka një korelacion të drejtë mes këtyre të fundit dhe sasisë së veprave penale të konsumuara dhe që janë nën hetim. Të dhënat paraqiten në tabelën në vijim:

Fig. 4 - Sasia e gjykimeve me marrëveshje sipas figurave të veçanta të veprës penale

| Gjykimet sipas veprave penale | Me marrëveshje | Gjykime gjithsej | Përqindja e gjykimeve me marrëveshje |
|--|----------------|------------------|--------------------------------------|
| Neni 291 – Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt | 254 | 1296 | 20 % |
| Neni 137/1 – Vjedhja e energjisë elektrike | 30 | 166 | 18 % |
| Neni 199/a/1 – Ndërtimi i paligjshëm | 25 | 144 | 17 % |
| Neni 134/2 – Vjedhja | 9 | 304 | 3 % |
| Neni 130/a/1 – Dhuna në familje | 7 | 354 | 2 % |
| Neni 178 – Tregtimi i mallrave kontrabandë | 5 | 13 | 38 % |
| Neni 145 – Mashtrimi në sigurime | 2 | 53 | 4% |
| Neni 174 – Kontrabanda me mallra të tjerë | 2 | 8 | 25 % |
| Neni 190/2 – Falsifikimi i vulave, stampave dhe formularëve | 1 | 62 | 2% |
| Neni 121/a/1/2 – Përndjekja | 1 | 58 | 2 % |
| Neni 244 – Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj | 1 | 12 | 8% |
| Neni 279 – Prodhimi / mbajtja e armëve të ftohta | 1 | 5 | 20% |
| Neni 172 – Kontrabanda me mallra për të cilat paguhet akcizë | 1 | 1 | 100% |
| Neni 124/1 – Braktisja e fëmijëve të mitur | 1 | 14 | 7% |
| Neni 293/b/1 – Ndërhyrjanë të dhënat kompiuterike | 1 | 2 | 50% |

Nga të dhënat më sipër rezulton se nuk ndiqet ndonjë kriter që të krijojë efekte të dukshme në përdorimin e gjykimeve me marrëveshje. Nuk ka një raport proporcional në shpeshhtësinë e gjykimeve me marrëveshje dhe shpeshhtësisë së veprës penale të gjykuar. Madje, e logjikshme do të ishte që përqindja më e lartë duhej të shfaqej në gjykimin e veprave që kryhen shpesh, pasi këto janë ato vepra që ngarkojnë punën e prokurorisë dhe kjo e fundit ka interes që t'i "shkarkojë" ato me shpejtësi përmes gjykimeve me marrëveshje. Kështu p.sh. vepra penale më e gjykuar është ajo e drejtimit të automjetit në gjendje të dehur me një numër gati 4 herë më të madh se vepra e dytë që e ndjek, vjedhja. Megjithatë vetëm në 20% të rasteve lidhet marrëveshje për këtë veprë penale, ndërsa për veprën e dytë raporti është në masën 18%. Raporti statistikisht relevant më i ngushtë i lidhjes së marrëveshjes me shpeshhtësinë e gjykimit të një veprë penale është për veprën penale "Tregtimi i mallrave kontrabandë" dhe "Kontrabanda me mallra të tjerë" ku gjykimet me marrëveshje janë respektivisht në 38% dhe 25% të rasteve. Duket se për këto vepra penale ka një "preferencë" në lidhjen e marrëveshjes, nga ana e prokurorisë.


Në përgjithësi mund të themi se mungojnë kriteret ligjore mbi të cilat prokurori i një çështjeje vendos nëse do të propozojë apo jo një marrëveshje, ndaj gjithshka është në diskrecionin e tij, gjë e cila mund të ushqejë arbitraritetin. Gjithashtu vlerësojmë se një pjesë e mirë e veprave penale, mund të ishin mbyllur me marrëveshje edhe për shkak të rrezikshmërisë së ulët të veprës penale, siç është psh pjesëmarrja ose organizimi i protestave të paligjshme, të cilat nuk kanë sjellë pasoja, etj.

Mungesa e kriterëve ligjore është e pritshme sepse ky instrument përdoret sipas nevojave dhe organi i prokurorisë duhet të ketë fleksibilitetin e duhur për ta zgjedhur ose jo përdorimin e tij. Por, për të shmangur arbitraritetin është e nevojshme që drejtuesit e prokurorisë, ose Prokurori i Përgjithshëm, sipas nevojave që paraqiten, të rregullojnë këtë proces përzgjedhjeje me anë të urdhërave dhe udhëzimeve të brendshme, për të mos e lënë një diskrecion të pakontrolluar në dorë të prokurorëve të çështjeje.

4. Raporti i marrëveshjeve të lidhura mes prokurorit dhe të pandehurit, në krahasim me ato që janë pranuar nga gjykata

Grafiku në vijim ofron një pasqyrë të plotë të të dhënave statistikore për raportin mes numrit të marrëveshjeve të pranuar dhe ato të rrëzuara nga gjykata në 16 muajt e periudhës së monitorimit.

Fig. 5 - Sasia e marrëveshjeve të pranuar nga gjykata




Nga grafiku më sipër rezulton se marrëveshjet e propozuara pranohen në pjesën dërrmuese të rasteve. Në vetëm 12 % të rasteve ato refuzohen nga Gjykata, ku arsyet mund të jenë të ndryshme. Nga studimi i 100 dosjeve të përzgjedhura rezulton që këto marrëveshje të jenë refuzuar më së shumti për arsyet e mëposhtme:

- Dënimi është cilësuar i papërshtatshëm;
- Cilësimi juridik i veprës penale ka qenë jo i saktë;
- Është tërhequr vetë i pandehuri nga marrëveshja;
- I pandehuri ishte i mitur dhe nuk janë respektuar dispozitat ndaluese në këtë rast;
- Marrëveshja është bërë pa praninë e avokatit mbrojtës;
- Pohimi i fajësisë nuk është bërë në formë të qartë.

5. Raporti i gjykimeve me marrëveshje, kur i pandehuri është mbrojtur nga një avokat i zgjedhur me ato të mbrojtur nga avokatë të caktuar kryesisht

Me qëllim vlerësimin e rëndësisë që kanë avokatët e caktuar kryesisht, shohim raportin që ato zënë në të gjitha llojet e gjykimeve me marrëveshje. Ky raport për 16 muajt e marrë në studim pasqyrohen në grafikun në vijim:

Fig. 6 - Sasia e çështjeve të mbrojtura nga avokatë të caktuar kryesisht




Nga të dhënat e paraqitura në grafik rezulton se në 59 % të rasteve të pandehurit gjatë lidhjes dhe miratimit të marrëveshjes janë mbrojtur nga avokatë të zgjedhur dhe në 41 % nga avokat të caktuar kryesisht, ose afërsisht gjysma e çështjeve. Ky numër i lartë i përfaqësimit të të pandehurve nga avokatët e caktuar kryesisht tregon sa ndikim ka ndihma juridike falas dhe sa e rëndësishme është ajo për interesin publik. Cilësia dhe efektiviteti i ndihmës juridike falas, ndikon në mbrojtjen e duhur në të gjitha çështjet, por merr një rol të veçantë në këto lloj gjykimesh të veçanta, pasi të pandehurit heqin dorë nga gjykimi duke iu nënshtruar vullnetit të organit të akuzës dhe duke prishur garancitë procedurale dhe barazinë e armëve.

6. Raporti i marrëveshjeve të rrëzuara nga gjykata në çështjet me avokat të zgjedhur, kundrejt atyre me avokat të caktuar kryesisht

Ndërsa është e vështirë të vlerësosh cilësinë e mbrojtjes mes avokatëve të zgjedhur dhe atyre të caktuar kryesisht, një nga elementët e këtij vlerësimi do të ishte edhe sa është përqindja e rasteve kur marrëveshja nuk është pranuar nga gjykata.

Sic rezuloi në grafikun nr. 5 më sipër, 12 % e marrëveshjeve nuk pranohen nga ana e gjykatës, ndërsa në grafikun në vijim jepen të dhënat se sa është raporti i rrëzimit të marrëveshjeve në rastet kur këto gjykime bëhen në prani të avokatit të caktuar kryesisht, krahasuar me avokatët e zgjedhur.

Fig. 7 - Rrëzimi i marrëveshjeve kur të pandehurit janë mbrojtur nga avokatë të caktuar kryesisht, krahasuar me rastet kur të pandehurit janë mbrojtur nga avokatët e zgjedhur



Sic rezulton nga grafiku më sipër rastet e pranimit të marrëveshjeve nga gjykata është më i mundshëm kur është avokati i caktuar kryesisht, por kjo e dhënë në kampionin e marrë nuk paraqet relevancë statistikore.

7. Përfaqësimi i të pandehurit nga i njëjti avokat si në fazën hetimore edhe gjatë gjyqimit

Siç kemi theksuar edhe në studimin e mëparshëm me temë efektivitetin e ndihmës juridike, mbrojtja e të pandehurit nga i njëjti avokat, që nga faza hetimore deri në fund të shqyrtimit

gjyqësor në të gjitha shkallët e gjykimit, paraqet avantazhe për arsye se një mbrojtje e plotë nënkupton një strategji mbrojtje konsistente, e cila nuk duhet të kompromentohet për shkak të ndërrimit të avokatëve. Të dhënat lidhur me këtë element jepen në tabelën në vijim:

Fig. 8 - Konsistenca e avokatit të caktuar kryesisht, në të gjitha fazat hetimore e gjyqësore

| Vendimet e gjykatës | I njëjti avokat gjatë gjithë procesit | Avokat të ndryshëm gjatë gjykimit dhe gjatë hetimit | Gjithsej avokatë të ndryshuar |
|--|---------------------------------------|---|-------------------------------|
| Gjykimet me avokatë të caktuar kryesisht | 146 | 16 | 10% |
| Gjykimet me avokatë të zgjedhur | 230 | 6 | 3% |

Nga studimi i dosjeve rezulton se në më të shumtën e rasteve, avokatët nuk kanë ndryshuar. Më konkretisht nga studimi rezultoi se në mesatare për të dyja kategoritë, vetëm në 6 % të rasteve i pandehuri nuk ka pasur të njëjtin avokat gjatë nënshkrimit të marrëveshjes dhe gjatë gjykimit. Ndryshimet e avokatit vihen re në masë më të madhe kur mbrojtja është bërë nga avokati i caktuar kryesisht, konkretisht në 10% të rasteve, krahasuar me më pak se 3 % të rasteve kur është ndërruar avokati i zgjedhur.

Një e dhënë tjetër interesante është se në 3 raste (nga 16), ku avokati i caktuar kryesisht është ndryshuar, rezulton të jetë zëvendësuar me një avokat të zgjedhur nga i pandehuri, gjë që mund të sugjerojë për mungesë të besimit mes të pandehurit dhe avokatit të tij, të caktuar. Kjo mund ta këtë shpjegimin te fakti se mund të ndodhë që për shkak të neglizhencës së avokatëve të caktuar kryesisht për të kontaktuar dhe krijuar një marrëdhënie besimi me klientin e tij/saj, pa diskutuar këtu cilësinë e mbrojtjes, e cila nuk mund të vlerësohet objektivisht nga klienti.


Megjithatë për ato raste kur ndërrimi i avokatëve të caktuar kryesisht është në përgjegjësinë e mënyrës së zgjedhjes së tyre, vlen të theksohet se do të ishte në interes të të pandehurit ndjekja nga i njëjti avokat i çështjes nga fillimi deri në fund të procedimit penal, përveç rasteve kur kjo nuk pranohet nga vetë i pandehuri.

Ndërsa në 2 raste (nga 6 raste) i pandehuri ka ndryshuar avokatin e zgjedhur gjatë hetimit, duke e zëvendësuar atë me avokat të caktuar kryesisht, gjatë gjykimit. Mendojmë që në këto pak raste avokati i zgjedhur thjesht nuk është paraqitur në seancë dhe gjykata ka vijuar procesin duke thirrur një avokat kryesisht për të përfunduar formalisht seancën.

8. Shpeshësia e gjykimeve me marrëveshje në periudhën Janar 2018 – Prill 2019

Siç përmendëm më sipër gjykimi me marrëveshje është një institut i ri në të drejtën penale dhe për këtë arsye praktika e lidhur me të është ende e pakët. Ndaj nuk mund të vlerësojmë sa i dëshirueshëm është ky lloj gjykimi. Megjithatë në tabelën në vijim duket trendi i zgjedhjes së këtij lloj gjykimi në kohën e monitoruar nga ana jonë. Të dhënat tregohen në tabelën në vijim:

Fig. 9 - Trendi i shpeshtësisë së gjyqimeve me marrëveshje gjatë periudhës Janar 2018 – Prill 2019



Nga grafiku më sipër rezulton se kemi një rënie të gjyqimeve me marrëveshje, që vjen gradualisht në fillim të vitit 2018 dhe deri sa arrin nivelin më të ulët gjatë muajve të parë të vitit 2019, ku numri i tyre zbret deri afër 0. Konkretisht viti 2018 ka nisur me mbi 70 gjykime me marrëveshje dhe në muajt e parë të monitoruar të vitit 2019 ka zbritur deri në 1 gjykim të tillë në muaj. Ky rezultat mund ta ketë shpjegimin te fakti i “frikës nga humbja e pushtetit” dhe presionit të ushtruar prokurorëve nga gjyqtarët, pasi siç thamë më lart, gjykimi me marrëveshje është shtim i pushtetit të prokurorit, i cili i hiqet gjykatës. Një gjë e tillë raportohet edhe nga kryetari i shoqatës së penalistëve të Shqipërisë ku në një artikull⁵⁹ citon se:

“Këtu fillon “Alergjia” apo paligjshmëria e gjyqtarëve të cilët në të shumtat e rasteve e refuzojnë marrëveshjen ligjore që lidhet midis prokurorit dhe të pandehurit pa asnjë arsyetim, duke “dyshuar” te ligjshmëria e saj me preteksin që jam unë gjyqtari që vendos dhe realizoj dhënien e drejtësisë!!!”

Ky veprim i gjykatës është një skandal i vërtetë dhe kërkon vëmendjen e KLGJ apo nga inspektorët duke kontrolluar të gjitha vendimet gjyqësore ku gjyqtarët refuzojnë marrëveshjet e realizuara gjatë fazës së hetimeve paraprake midis prokurorit dhe të pandehurit...”

Në intervistat me gjyqtarët, të bëra në kuadër të këtij studimi, disa prej tyre dëshmojnë se disa kolegë të tyre nuk i preferojnë gjykimet me marrëveshje dhe ndikojnë tërthorazi te prokurorët për të mos sjellë gjykime të tillë. Kjo përforcon dyshimin se në të ardhmen gjykimet me marrëveshje do të bëhen një dukuri gjithnjë e më e rrallë.

Duhet thënë se në grafikun më sipër qëllimisht nuk pasqyrohet muaji Gusht 2018, për shkak se gjatë këtij muaji nuk zhvillohen gjykime për shkak të pushimeve verore të pushtetit gjyqësor.

9. Të dhëna nga gjykatat e rretheve

Gjatë studimit u grumbullua informacion i përgjithshëm edhe nga gjykatat e rretheve, përvec

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me gjykimet me marrëveshje. Në vijim jepen disa nga këto të dhëna të marra për harkun kohor të një viti, e konkretisht u vlerësua si është raporti i gjykimit me marrëveshje me gjykimet e zakonshme dhe si është raporti i marrëveshjeve të pranuar nga gjykata me ato të rrëzuara. Të dhënat e mbledhura nga gjykatat u krahasuan edhe me të dhënat e marra nga prokuroritë e rretheve për të siguruar saktësinë e informacionit.

Fig. 10 - Numri i gjykimeve me marrëveshje në raport me gjykimet e zakonshme në rrethe

| Gjykatat e rretheve | Nr. i gjykimeve në tërësi | Nr. i gjykimeve me marrëveshje | Në përqindje |
|---------------------|---------------------------|--------------------------------|--------------|
| Gjirokastrë | 465 | 61 | 13% |
| Lushnje | 371 | 43 | 12% |
| Pogradec | 816 | 82 | 10% |
| Kavajë | 253 | 24 | 9% |
| Berat | 511 | 45 | 9% |
| Dibër | 328 | 23 | 7% |
| Mat | 71 | 5 | 7% |
| Kurbin | 213 | 12 | 6% |
| Vlorë | 781 | 42 | 5% |
| Fier | 584 | 28 | 5% |
| Shkodër | 2112 | 91 | 4% |
| Elbasan | 821 | 27 | 3% |
| Lezhë | 609 | 15 | 2% |
| Krujë | 269 | 5 | 2% |
| Pukë | 69 | 1 | 1% |
| Përmet | 76 | 0 | 0% |
| Mesatare | | | 6% |

Fig. 11 - Marrëveshjet e pranuar në raport me marrëveshjet e rrëzuara

| Gjykatat e rretheve | Të pranuar | Të rrëzuara | Përqindja e marrëveshjeve të pranuar |
|---------------------|------------|-------------|--------------------------------------|
| Kavajë | 24 | 0 | 100% |
| Pukë | 1 | 0 | 100% |
| Dibër | 22 | 1 | 96% |
| Gjirokastrë | 57 | 4 | 93% |
| Kurbin | 11 | 1 | 92% |
| Pogradec | 74 | 8 | 90% |
| Berat | 40 | 5 | 89% |
| Vlorë | 37 | 5 | 88% |
| Shkodër | 77 | 14 | 85% |
| Krujë | 4 | 1 | 80% |
| Mat | 4 | 1 | 80% |
| Lushnje | 34 | 9 | 79% |
| Elbasan | 21 | 6 | 78% |
| Fier | 19 | 9 | 68% |
| Lezhë | 8 | 7 | 53% |
| Mesatare | | | 86% |

Në shkallë vendi vihet re se numri i gjykimeve me marrëveshje është dy herë më i ulët (6%) se në Tiranë (12%), ndërsa niveli i pranueshmërisë së marrëveshjeve nga gjykatat mbetet në nivele të përafërta (86%) me Tiranën (88%). Veçanërisht, në rrethin e Shkodrës numri i çështjeve është i lartë dhe do justifikonte gjykimet me marrëveshje, por duket se ato preferohen vetëm në 4% të rasteve, me efekt të pandjeshëm në ekonominë e burimeve të hetimit.

Ndërkohë vihet re një nivel i lartë i rrëzimit të marrëveshjeve nga gjykatat në Lezhë dhe Fier, duke sugjeruar se ka një nivel të lartë të parregullsive në përdorimin e këtij mjeti ligjor. Sidomos në Lezhë, spikat fakti që ky mjet përdoret tepër rrallë (2% të rasteve) dhe gjysma e tyre nuk janë të sukseshme në gjykatë, çka sugjeron që motivimi i prokurorisë për të arritur një marrëveshje nuk është sipas interesave të ideuara nga ligjvënësi.

10. Masa e dënimeve kur i pandehuri është mbrojtur nga një avokat i zgjedhur në raport me rastet kur i pandehuri është mbrojtues nga një avokat i caktuar kryesisht

Me qëllim për të parë se si janë mbrojtur më së miri interesat e të pandehurve, vlerësuam të analizonim të dhënat e rezultuara nga masa e dënimit të rënë dakord në marrëveshje në rastet kur i pandehuri mbrohet nga një avokat i zgjedhur dhe në rastet kur ai mbrohet nga një avokat i caktuar kryesisht. Kjo e dhënë është një nga elementët që mund të na ndihmojë për të vlerësuar cilësinë e ndihmës juridike falas. Për efekt studimi janë marrë në analizë i njëjti numër çështjesh ku mbrojtësi ka qenë avokat i caktuar kryesisht me ato ku mbrojtësi ka qenë avokat i zgjedhur i të pandehurit, për të njëtat vepra penale, me qëllim nxjerjen e të dhënave sa më të sakta. Të dhënat janë sipas tabelës në vazhdim:

Fig. 12 - Dënimet e dhëna në rastet e mbrojtura nga avokatët e zgjedhur në krahasim me rastet kur mbrojtja është bërë nga avokatët e caktuar kryesisht

| Dënimet e dhëna | Gjykime me marrëveshje me avokatë të zgjedhur | Gjykime me marrëveshje me avokatë të caktuar kryesisht | Ndryshimi në përqindje |
|-----------------|---|--|------------------------|
| Neni 291 | 39.3 muaj | 36 muaj | -9% |
| Neni 137/1 | 55 muaj | 45 muaj | -19% |
| Neni 199/a | 28 muaj | 24 muaj | -14% |
| Neni 134/1 | 8 muaj | 23 muaj | +288% |
| Neni 130/a/1 | 6 muaj | 4 muaj | -33% |
| Neni 189/1 | 10 muaj | 6 muaj | -40% |
| Neni 273 | 2 muaj | 2 muaj | 0 |
| Mesatare | | | -7% |

Nga të dhënat më sipër duket se edhe pse në një masë të vogël, avokatët e zgjedhur arrijnë numër më të madh dënimesh, gjë që në pamje të parë duket se tregon për një punë cilësore të avokatëve të caktuar kryesisht. Sipas raportit të Transparency International, "Plea Bargaining in Georgia: Negotiated Justice, 2010", citohet se prokurorët gjeorgjianë kanë përdorur nxitjen e një dënimi më të ulët për "bindjen" e të pandehurve për të hequr dorë nga avokatët që prokurorët nuk i pëlqejnë. Në disa raste madje është raportuar se emërimi i një avokati të ri (me gjasa më i përpunueshëm nga prokurori) është pjesë e vetë marrëveshjes. Nga ky këndvështrim, duket se ka një lidhje logjike me faktin që prokurorët nuk preferojnë të bëjnë negociata me avokatët e zgjedhur, por më shumë preferojnë negociata direkte, duke përfshirë më pas një avokat të caktuar kryesisht prej vetë tyre sa për të formalizuar procedurën. Negociata direkte mes prokurorit dhe të pandehurit e vë prokurorin në pozicionin që të luajë ai rolin e avokatit,

duke shmangur avokatin e vërtetë, i cili i “hyn në pjesë” duke marrë një pjesë të shpërblimit. Në këto raste, nëse kjo është edhe situata në Shqipëri (ku duket qartë që në rastin e avokatëve të caktuar kryesisht negociata është disi më e suksesshme), jemi të mendimit se ky është tregues i korrupsionit dhe mbetet për t’u vëzhguar më thellë nga organet përkatëse.

11. Dënimi mesatar për veprat në gjykimin e zakonshëm, krahasuar me mesataren e dënimit në gjykimin me marrëveshje

Me qëllim për të vlerësuar se sa është përfitimi i të pandehurve nga pranimi i marrëveshjes, kemi mbledhur të dhënat nga vendimet e gjykimit me marrëveshje dhe i krahasuam me të dhënat e vendimeve me gjykime të zakonshme, sipas metodologjisë më poshtë. U përzgjedhën 20 vendimet e para që ofronte kërkimi në faqen online të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për secilën vepër penale, për të cilën mund të bëhej eventualisht gjykimi me marrëveshje. Veprat penale të monitoruara janë ato më shpesh të gjykuara gjatë vitit 2018. Të dhënat e mbledhura paraqiten në tabelën në vijim:

Fig. 13 - Dënimet e dhëna në gjykimet me marrëveshje në raport me gjykimet e zakonshme (përshirë gjykimet e shkurtuara)

| Lloji i veprës penale | Dënimet mesatare në gjykimet me marrëveshje | Dënimet mesatare në gjykime të zakonshme | Reduktimi i dënimit, në përqindje |
|--|---|--|-----------------------------------|
| 1 Neni 89 - Plagosja e lehtë me dashje | 2 muaj burgim | 3.3 muaj burgim | 39% |
| 2 Neni 134/1 - Vjedhja | 2.6 muaj burgim | 8.6 muaj burgim | 70% |
| 3 Neni 134/2 - Vjedhja | 14 muaj burgim | 20.6 muaj burgim | 32% |
| 4 Neni 137/1 - Vjedhja e energjisë elektrike | 3.6 muaj burgim | 3.7 muaj burgim | 3% |
| 5 Neni 145 - Mashtrimi në sigurime | 4.5 muaj burgim | 3.9 muaj burgim | -15% |
| 6 Neni 189/2 - Falsifikimi i pasaportave ose vizave | 4 muaj burgim | 7.8 muaj burgim | 49% |
| 7 Neni 199/1 - Ndërtimi i paligjshëm | 3.6 muaj burgim | 10.2 muaj burgim | 65% |
| 8 Neni 242 - Mosbindje ndaj urdhërit të punonjësit të policisë | 2.4 muaj burgim | 1.3 muaj burgim | -85% |
| 9 Neni 291 - Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt | 1.8 muaj burgim | 3 muaj burgim | 40% |
| Mesatare | | | 15% |

Sic shihet nga tabela më sipër, ekziston një reduktim i dënimit mesatar nëse zbatohet gjykimi me marrëveshje, pavarësisht se ky reduktim nuk ndodh gjithmonë dhe në mesatare është relativisht i vogël, gjë që dëshmon për përfitim të vogël të të pandehurve nga gjykimet me marrëveshje.

12. Marrja parasysh e preferencave të të pandehurit në caktimin e një avokati kryesisht

Nga studimi i mëparshëm⁶⁰ rezultoi se pavarësisht formulimit në Kushtetutë, lidhur me shprehjen e vullnetit të të pandehurit në caktimin e një avokati, një i pandehur nuk e zgjedh realisht vetë avokatin mbrojtës. Ky i fundit caktohet nga organi procedues gjykata apo prokuroria. Ndërsa është e zakonshme që i pandehuri i aftë për të paguar një avokat, e zgjedh këtë vetë, shohim se si realizohet e drejta për të zgjedhur avokat, në rastin kur ai caktohet kryesisht nga prokurori/ gjykata. Edhe në këtë studim Res Publica bëri një sondazh për të parë shpeshësinë e emërimit të avokatëve me emra konkretë gjatë gjykimit me marrëveshje, si në fazën e miratimit të marrëveshjes edhe gjatë gjykimit. Nga ky sondazh dolën të dhënat e reflektuara në tabelën në vijim.

Fig. 13 - Shpeshësia e caktimit të avokatëve konkretë nga skema e ndihmës juridike

| Avokatët e caktuar kryesisht (inicialet) | Numri i çështjeve të identifikuar gjatë Janar 2018 – Prill 2019 | Shpërndarja e çështjeve në % |
|--|---|------------------------------|
| D.C. | 23 | 14 % |
| D.B | 18 | 11 % |
| F.N. | 17 | 10 % |
| V.T. | 15 | 9 % |
| O.M | 10 | 6 % |
| M.R | 6 | 4 % |
| N.P. | 5 | 3 % |
| 6 avokatë | 4 çështje | 15 % |
| 2 avokatë | 3 çështje | 4 % |
| 7 avokatë | 2 çështje | 9 % |
| 24 avokatë | 1 çështje | 15 % |
| Total 46 avokatë | 162 çështje | 100% |

Nga të dhënat më sipër vihet re se nga lista me avokatë të vënë në dispozicion nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë prej 129 avokatësh, 3 prej tyre përballojnë 35 % të gjithë çështjeve. Gjithashtu të dhënat tregojnë se avokati më i përzgjedhur si mbrojtës i të pandehurit në lidhjen e marrëveshjes, që kryeson listen, caktohet në tre çështje në dy muaj, ndërsa 31 avokatë (23% e listës) caktohen në vetëm 1 deri në dy çështje gjatë të gjithë periudhës 16 mujore. Ndërsa 83 (64% e listës) avokatë të tjerë nuk janë caktuar në asnjë çështje.

Duke analizuar këto të dhëna, duket qartë një trend i caktimit të avokatit kryesisht sipas “preferencave” të organit procedues, gjë që tregon edhe një herë për lidhjen e fortë mes avokatit dhe organit procedues, që në rastin e prokurorit ndikon edhe më shumë në cilësinë e punës së avokatit dhe mbrojtjes së interesave të të pandehurit, klient i tij/saj, ndërsa nuk mund t’i shmanget ndikimit të konfliktit të interesit që ekziston mes avokatit dhe prokurorit. Një praktikë e tillë do të korrigohej përmes një skeme të pavarur të caktimit me rotacion të avokatit kryesisht, sugjerim që Qendra Res Publica e ka bërë edhe në hartimin e udhëzimit përkatës për zbatimin e parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve të ndihmës juridike.

⁶⁰ “Efektiviteti I ndihmës juridike në procesin penal në Shqipëri”, <http://www.respublica.org.al/wp-content/uploads/2016/05/Efektiviteti-i-ndihmes-juridike-ne-procesin-penal-ne-Shqiperi-Res-Publica-Mars-2016.pdf>

13. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore për pranimin e marrëveshjes, në lidhje me konfirmimin e vullnetit të të pandehurit

Gjykata ka për detyrë që gjatë gjykimeve për pranimin e marrëveshjes të sigurojë efektivisht shqyrtimin e disa elementëve të një çështjeje të tillë, në veçanti vullnetin e të pandehurit, përshtatshëmrinë e dënimit të propozuar, dhënies së ndihmës juridike me efektivitet, si dhe të mjaftueshmërisë *prima facie* të provave kundër të pandehurit.

Raportohen raste kur gjykata nuk ka hetuar fare lidhur me vullnetin e të pandehurit. Në një çështje gjykata nuk u investua fare në këtë drejtim, por u mjaftua me pranimin e marrëveshjes duke pyetur formalisht të pandehurin a ishte dakord. Madje, as edhe fakti që i pandehuri deklaroi se ishte analfabet, nuk i tërhoqi vëmendjen gjykatës, për si e kishte kuptuar ai marrëveshjen. Në këtë rast çështja u ndoq me avokat të caktuar kryesisht në prokurori dhe në gjykatë nga avokat i zgjedhur.

Në përgjithësi vihet re një arsyetim sipërfaqësor i gjykatës duke mbushur pjesën arsyetuese me pjesë teorike më shumë se me pjesë arsyetuese mbi kazusin e gjykuar, me përjashtime tepër të rralla.

IV. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

1. Përfundime

1.1. *Përfundime nga vështrimi i legjislacioneve dhe praktikave të huaja*

Gjykimet me marrëveshje kanë një popullaritet që vijon të rritet, sidomos në ato sisteme ku zbatohet drejt dhe përfitojnë të dyja palët, edhe prokuroria, edhe të pandehurit. Hetimet bëhen më efikase dhe nuk konsumojnë shumë burime, ndërkohë që të pandehurit marrin dënime më të lehta.

Pavarësisht se gjykimet me marrëveshje kanë shumë elementë të heqjes dorë nga gjykimi, duke cenuar garancitë procedurale për të pandehurit, sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk ngrihen çështje të bazuara në 6 të Konventës, për sa kohë që heqja dorë është e vetëdijshme dhe e kuptuar, janë saktësuar në mënyrë të qartë elementët e saj, respektohet një minimum mbrojtjeje në përpjesëtim me rëndësinë e të drejtave nga të cilat është hequr dorë dhe nuk është kundër ndonjë interesi të rëndësishëm publik.

Ndër vendet ku gjykimet me marrëveshje përdoren në mënyrë të gjerë renditen së pari SHBA (vendi i cili e ka përhapur kulturën e përdorimit të këtij mjeti juridik), ku mbi 97% e të pandehurve federalë dhe 94% e të pandehurve të shteteve dënohen në bazë të një marrëveshjeje fajësie dhe jo përmes gjyqimit të rregullt. Përqindje të ngjashme vihen re edhe në vendet e tjera si Gjeorgjia ku përqindja ka arritur afro 90%, apo Kolumbia për të cilën raportohet se masa e këtyre gjykimeve arrin në 98%. Në vende të tjerë shifrat janë më të ulëta, si Gjermania (rreth 50%) apo Maqedonia e Veriut (rreth 66%). Ndërsa ekzistojnë praktika më të zbehta ku vlen për t'u veçuar rasti i Italisë në të cilën gjykimi me marrëveshje zbatohet në rreth 15 % të rasteve, apo Kroacia që trajton në këtë mënyrë më pak se 4% të rasteve.

Edhe pse në parim gjykata mund të refuzojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë për një numër arsyesh, në praktikë kjo ndodh vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe përqindja e pranimit të marrëveshjeve është shumë pranë 100%.

Sistemi i negociatave për marrëveshjen e fajësisë në SHBA ka pasur kritika të ashpra. Një fakt domethënës është që në vitin 2016, 44.5% e të dënuarve që fituan më pas pafajësinë në SHBA kishin të bënin me të pandehurit që ishin shpallur fajtor me anë të një marrëveshjeje për pranimin e fajësisë, duke sugjeruar që të pandehurit e pafajshëm mund të shtrëngohen të pranojnë fajin për të shmangur gjyqin me një rezultat të pasigurt, që nëse shpallen fajtorë, rezultati është më i keq.

Përfshirja e sistemit të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë, si ai që aplikohet në SHBA dhe dhënia e diskrecionit shtesë prokurorëve, duket se ka përkeqësuar problemet ekzistuese në rendet juridikë ku ky sistem është implementuar. Në Bosnje shumica e të pandehurve që kanë pranuar një marrëveshje fajësie e bëjnë këtë para se të binin dakord me prokurorin lidhur me dënimin e tyre, ndërsa të pandehurit as nuk ishin të përfaqësuar nga një avokat. Kritikët janë shprehur mbi pushtetin e gjerë të prokurorit në kontekstin e marrëveshjes së fajësisë, duke argumentuar se mungesa e standardeve objektive dhe mospërputhja e ka bërë marrëveshjen e pranimit të fajësisë të “... shfaqet në kuptimin e saj më të keq”. Prokurorët gjergjjanë gjithashtu kanë përdorur nxitjen e një dënimi më të ulët për “*bindjen*” e të pandehurve për të hequr dorë nga avokatët që prokurorët nuk i pëlqejnë, madje në disa raste është raportuar se emërimi i një avokati të ri (më të përpunueshëm nga prokurori) është pjesë e vetë marrëveshjes. Në Maqedoninë e Veriut, mungesa e transparencës rreth marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë është përdorur për të mbyllur çështjet e ndjeshme politike, ndërsa prokurorët (dhe gjyqtarët) kanë përdorur paraburgimin si një mjet presioni në negociata me qëllim që të nxisnin të pandehurit të nisnin bisedimet për një marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Megjithatë, sa më lart nuk nënkupton që sistemet e marrëveshjeve për pranimin e fajësisë janë strukturalisht në kundërshtim me të drejtat procedurale penale të të pandehurit. Për mirë ose për keq, sistemet e heqjes dorë nga gjykimi do të mbeten një tipar i shumicës së sistemeve ligjore për shkak të përparësive që ato ofrojnë në drejtim të menaxhimit të burimeve të pakta në dispozicion të organeve të drejtësisë. Si rezultat, çështja kryesore në diskutim sot është si mund të bëhen më të barabarta dhe të ndershme këto sisteme. Defekti më i madh i tyre (sipas stilit amerikan) është pikërisht dhënia e një diskrecioni pothuajse të shpenguar prokurorit. Kjo çon në një shtrembërim pothuajse automatik të procedimeve kundër të pandehurit, pasi njëra palë nuk ka asgjë për të humbur dhe tjetra ka gjithçka për të humbur nëse nuk arrihet një marrëveshje.

Shembull i përpjekjeve për të shmangur abuzimet është rasti i Italisë ku me ligj është ushtruar kujdes për të mbajtur nën kontroll diskrecionin e prokurorisë, duke e kufizuar atë sa më shumë që të jetë e mundur. Në Itali gjykimet me marrëveshje nuk trajtojnë heqjen e akuzave por trajtojnë vetëm zbutjen e dënimit, i cili është përcaktuar në ligj sa ulët (një e treta e dënimit). I pandehuri ka të drejtë të kundërshtojë refuzimin e prokurorit për të nisur bisedimet dhe prokurori duhet të japë arsye për refuzimin e tij. Nëse prokurori nuk respekton këtë detyrim, gjykata mund ta shmangë prokurorin dhe të vendosë vetë zvogëlimin e dënimit.

Duke pasur parasysh gjetjet e mësipërme, si dhe vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastet e negociimit të marrëveshjes të fajësisë, duhet të krijohen masa mbrojtëse, p.sh. ndihma juridike të jetë efektive, të sigurohet qasje në kohën e duhur dhe me lehtësitë e përshtatshme. Sistemet e heqjes dorë nga gjykimi nuk duhet të konsiderohen si një mekanizëm për të anashkaluar masat mbrojtëse procedurale të zakonshme, por duhet të jenë të pajisura me një nivel të barabartë mbrojtjeje procedurale ndaj asaj që është e mundur për të pandehurit në procedurat e zakonshme penale.

1.2. Përfundime nga analiza e sistemit në Shqipëri

Gjykimi me marrëveshje përbën një risi për legjislacionin shqiptar.

Kodi i Procedurës Penale i lë prokurorit një hapësirë relativisht të gjerë për lidhjen e marrëveshjes, duke nisur që nga çasti i regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale, derisa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor. Mund të thuhet se mungojnë kriteret mbi të cilat prokurori i një çështjeje vendos nëse do të propozojë apo jo një marrëveshje, ndaj gjithshka është në diskrecionin e tij, gjë e cila mund të ushqejë arbitraritetin. Prokurori nuk është i detyruar të hyjë në negociata për të bërë marrëveshje kundrejt propozimit të të pandehurit dhe nuk parashikohet as detyrimi i prokurorit për të dhënë një vendim të arsyetuar për refuzimin e marrëveshjes.

Ekziston një paqartësi në ligj në lidhje me momentin e fundit se kur mund të pranohet kërkesa për marrëveshje. Sipas një interpretimi të ngushtë, palët mund ta kërkojnë arritjen e një marrëveshjeje në seancën parapake. Në një interpretim të gjerë, kërkesa për marrëveshje mjafton që të paraqitet para shqyrtimit gjyqësor, kur seanca parapake është mbyllur dhe çështja është dërguar për gjykim.

Ekziston një pasaktësi në nenin 406/dh të Kodit të Procedurës Penale, ku thuhet se në rast se marrëveshja paraqitet në seancë parapake, gjykata vendos sipas parashikimeve të paragrafit 4, të nenit 332/c, të këtij Kodi. Ndërkohë që neni 332/c, paragrafi 4 parashikon diçka tjetër dhe referenca duket e gabuar. Këtë ngërç mund ta zgjidhë vetë legjislatori, ose praktika gjyqësore.

Meqenëse gjykimi me marrëveshje është në vetvete në disfavor të të pandehurit, meqë ky i fundit heq dorë nga gjykimi dhe bashkë me të nga disa të drejta procedurale, atij i duhet siguruar mbrojtje juridike efektive dhe jo thjesht formale. Në rastin kur avokati është i zgjedhur nga i pandehuri, kjo garanci sigurohet përmes tregut të lire, por vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet avokatëve të caktuar kryesisht, të cilët duhet të jenë të trajnuar dhe mbi të gjitha të motivohen edhe nga pagesa të drejta që të kryejnë me cilësi detyrën e caktuar.

Në rastin kur marrëveshja vlerësohet nga gjykata, dhe kjo seancë logjiksht është publike, nëse rezulton me rrëzimin e marrëveshjes dhe kthimin e çështjes për hetim, do të kishim cenim të privatësisë së të pandehurit, i cili në rastin kur nuk heq dorë nga gjykimi seanca nuk është publike.

Dispozitat ligjore nuk i njohin të drejta viktimës së veprës penale për të ndërhyrë, edhe pse pas nënshkrimit të marrëveshjes, prokurori ka detyrimin të njoftojë viktimën ose trashëgimtarët e saj. I vetmi rol i viktimës në gjykimin me marrëveshje është gjatë shqyrtimit të saj nga gjykata, por edhe në këtë rast viktimë thjesht ftohet të japë një mendim për përmbajtjen e marrëveshjes. Ligji nuk i njeh ndonjë të drejtë viktimës që ta kundërshtojë marrëveshjen, të shprehet për pranimin ose rrëzimin e saj. Viktimë është subjekti më i interesuar për një hetim të plotë dhe të gjithanshëm në emër të zbardhjes së të vërtetës, kur kjo e fundit nuk ka vlerë vetëm për dënimin e fajtorit por edhe për interesa të drejtësisë. Pikërisht një hetim i plotë dhe i gjithanshëm në këtë kuptim do të ishte ai i bërë përmes procedurave të një gjykimi të zakonshëm. Kjo mungesë e të drejtave të viktimës vjen në të njëjtën linjë me ligjin shqiptar, i cili është tepër i vakët në lidhje me të drejtat e tjera të viktimës.

Nuk ka një qartësi finale në ligj se çfarë ndodh në rastin kur i dënuari kërkon të revokohet vendimi. I pandehuri mund të kërkojë rishikimin e vendimit të gjykatës që ka miratuar marrëveshjen e fajësisë, me shkakun e daljes së një prove të re, që nëse dihej në kohën

e shqyrtimit të marrëveshjes nga gjykata, ajo nuk do e miratonte atë. Megjithatë praktika gjyqësore mund ta zgjidhë këtë aspekt bazuar në logjikën që të gjithë vendimet mund të rishikohen, përfshirë edhe vendimet e gjykatës për miratimin e marrëveshjes.

Modeli i zgjedhur nga legjislatori shqiptar, duke e kufizuar lidhjen e marrëveshjes së fajësisë në ato vepra penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore është i drejtë në përgjithësi. Por edhe ky model ka dobësitë e veta që qendrojnë në faktin se disa vepra penale, problematike dhe të shpeshta në vendin tone, si shpërdorimi i detyrës, shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike, veprat penale ndaj zgjedhjeve të lira, apo ato ndaj mjedisit mund të përfshihen në mundësinë e mos hetimit të thelluar, duke pranuar marrëveshjen. Gama e veprave të trajtueshme me gjykim me marrëveshje është përsëri tepër e madhe dhe diskrecioni i prokurorit për krime që cenojnë rendin demokratik, pasurinë publike, mjedisin ku jetojmë, është i tepërt.

Në një vend me nivel të lartë të perceptuar të korrupsionit këto vepra penale janë të shpeshta dhe për shkak të ndjeshmërisë së lartë publike do të ishte e rekomandueshme që të mos ishin pjesë e politikave penale që përfshijnë ofrimin apo pranimin e marrëveshjes nga ana e prokurorit për këto lloj veprash. Ekziston frika se marrëveshjet për disa vepra të caktuara penale mund të çojnë besueshmërinë e publikut tek drejtësia.

Megjithatë, zgjidhja që marrëveshja të jetë e lejueshme vetëm për një kategori veprash me rrezikshmëri të ulët, është një zgjidhje optimale, krahasuar me modelin e atyre vendeve që nuk vendosin kufizim për sa i përket masës së dënimit tek vepra penale.

Pavarësisht nga sa më sipër, në përgjithësi mund të themi se gjykimi me marrëveshje përmban një sërë problematikash dhe për praktikën gjyqësore do jetë e vështirë përshtatja e këtij lloj modeli, duke qënë se përbën edhe një risi për të.

1.3. Përfundime që dalin nga përpunimi i të dhënave nga praktika vendase

Në praktikë, 70 % e çështjeve mund të ishin gjykuar me marrëveshje fajësie, gjatë vitit 2018. Me fjalë të tjera, efekti i ekonomizimit të burimeve të hetimeve gjatë vitit 2018 mund të ishte shumë i konsiderueshëm, nëse do të veprohej si në SHBA, ose vende të tjerë ku zbatohet gjerësisht sistemi i heqjes dorë nga gjykimi.

Nga statistikat rezulton se masa e çështjeve të gjykuara me marrëveshje është vetëm 12 % në Tiranë dhe mesatarisht rreth 6% në rrethe të tjerë gjyqësorë. Këto shifra tregojnë se nga potenciali i përgjithshëm, niveli i përdorimit të këtij mjeti juridik është shumë i ulët.

Të dhënat demonstrojnë se ky numër është në rënie gjatë vitit 2019, duke u shfaqur gjithnjë e më pak i preferueshëm përdorimi i këtij mjeti juridik.

Nga të dhënat rezulton se nuk ka një raport proporcional në shpeshhtësinë e gjykimeve me marrëveshje dhe shpeshhtësisë së veprës penale të gjykuar. Raporti statistikiqisht relevant më i ngushtë i lidhjes së marrëveshjes me shpeshhtësinë e gjykimit të një veprë është për *“Tregtimin e mallrave kontrabandë”* dhe *“Kontrabanda me mallra të tjerë”* ku gjykimet me marrëveshje janë respektivisht në 38% dhe 25% të rasteve. Duket se për këto vepra penale ka një “preferencë” më të madhe në lidhjen e marrëveshjes, nga ana e prokurorisë.

Marrëveshjet e propozuara pranohen në pjesën dërrmuese të rasteve, mbi 86%. Nga studimi i dosjeve të përzgjedhura rezulton që këto marrëveshje të jenë refuzuar më së shumti për

arsye se dënimi është cilësuar i papërshtatshëm, cilësimi juridik i veprës penale ka qenë jo i saktë, si dhe është tërhequr vetë i pandehuri nga marrëveshja, etj.

Masa e çështjeve të mbrojtura nga avokatët e caktuar kryesisht është 41%, gjë që tregon se sa e rëndësishme është për interesin publik një cilësi e mirë dhe efektive e ndihmës juridike falas, në të gjitha çështjet, por veçanërisht në këto lloj gjykimesh.

Nga studimi i dosjeve rezulton se në 94% të rasteve i pandehuri është mbrojtur nga i njëjti avokat, gjë e cila është e rekomandueshme.

Rezulton se ka ndodhur një rënie graduale e trendit të gjykimeve me marrëveshje që nga viti 2018 deri në vitin 2019. Ky rezultat mund ta ketë shpjegimin te fakti i *“frikës nga humbja e pushtetit”* dhe presionit të ushtruar prokurorëve nga gjyqtarët, pasi gjykimi me marrëveshje përbën një shtim të pushtetit të prokurorit, i cili i hiqet gjykatës.

Niveli i rrëzimit të marrëveshjeve nga gjykatat nuk është i lartë (rreth 14% në shkallë vendi), por ekziston një nivel i lartë i rrëzimit të marrëveshjeve nga gjykatat në Lezhë dhe Fier. Sidomos në Lezhë spikat fakti që ky mjet përdoret tepër rrallë (2% të rasteve) dhe gjysma e tyre nuk janë të sukseshme në gjykatë, çka sugjeron që motivimi i prokurorisë për të arritur një marrëveshje nuk është sipas interesave të ideuara nga ligjvënësi.

Nga të dhënat më sipër duket se edhe pse në një masë të vogël, avokatët e zgjedhur arrijnë dënime më të larta, gjë që në pamje të parë duket se tregon për një punë cilësore të avokatëve të caktuar kryesisht. Duke marrë për bazë logjikën e sugjeruar nga raporti i Transparency International, *“Plea Bargaining in Georgia: Negotiated Justice, 2010”*, duket se ka një lidhje logjike me dyshimin që prokurorët nuk preferojnë të bëjnë negociata me avokatët e zgjedhur, por më shumë preferojnë negociata direkte, duke anashkaluar rolin e avokatit të caktuar, i cili në këtë rast përfshihet vetëm formalisht. Negociata direkte mes prokurorit dhe të pandehurit e vë prokurorin në pozicionin që të luajë ai rolin e avokatit, duke shmangur avokatin e vërtetë. Nëse kjo është e vërtetë (dhe kjo reflektohet edhe te fakti që në rastin e avokatëve të caktuar kryesisht negociata është disi më e suksesshme), jemi të mendimit se ky duhet të shihet si një tregues i mundësisë së ekzistencës së korrupsionit dhe mbetet për t’u hetuar nga organet përkatëse.

Ekziston një reduktim i dënimit mesatar nëse zbatohet gjykimi me marrëveshje, pavarësisht se ky reduktim nuk ndodh gjithmonë dhe në mesatare është relativisht i vogël (15%). Vihet re se nuk ka efekte të ndjeshme në rastin e veprës penale të vjedhjes së energjisë elektrike (vetëm 3% ulje dënimi), ndërkohë që ka efekt domethënës në veprën penale të ndërtimit të paligjshëm (65% ulje dënimi). Ky tregues sugjeron që të pandehurit që akuzohen për vjedhje të energjisë elektrike vijnë kryesisht nga shtresa të varfëra, ndërsa ata që akuzohen për ndërtim të paligjshëm (për vetë faktin që ndërtimi kërkon burime të konsiderueshme financiare) janë në një pozicion më të mirë ekonomik. Nëse ky faktor është ai që ndikon në masën e uljes së dënimit, atëherë mund të ngrihen dyshime për ekzistencën e korrupsionit në organin e akuzës.

Nga të dhënat vihet re se nga lista me avokatë të vënë në dispozicion nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë prej 129 avokatësh, 3 prej tyre përballojnë 35 % të gjithë çështjeve, 31 avokatë (23% e listës) caktohen në vetëm 1 deri në dy çështje gjatë të gjithë periudhës 16 mujore, ndërsa 83 avokatë të tjerë (64% e listës) nuk janë caktuar në asnjë çështje. Kjo demonstroi qartë një trend të caktimit të avokatit kryesisht sipas “preferencave” të organit procedues, gjë që tregon edhe një herë për lidhjen e fortë mes avokatit dhe organit procedues, që në rastin e

prokurorit ndikon edhe më shumë në cilësinë e punës së avokatit dhe mbrojtjes së interesave të të pandehurit, ndërsa nuk mund t'i shmanget ndikimit të konfliktit të interesit që ekziston mes avokatit dhe prokurorit.

Në lidhje me gjykimin, raportohen raste kur gjykata nuk ka hetuar fare lidhur me vullnetin e të pandehurit.

Në përgjithësi vihet re një arsyetim sipërfaqësor i gjykatës duke mbushur pjesën arsyetuese me pjesë teorike më shumë se me pjesë arsyetuese mbi kazusin e gjykuar, me përjashtime tepër të rralla.

2. Rekomandime

Duke pasur parasysh gjetjet e mësipërme, rekomandojmë sa më poshtë:

Rekomandimi nr. 1

Të pandehurve duhet t'u sigurohet mbrojtje e detyrueshme si ajo e parashikuar në nenin 48 të Kodit të Procedurës Penale, në rastin e përdorimit të gjykimit me marrëveshje (gjatë negociatës dhe gjatë shqyrtimit të marrëveshjes nga gjykata).

Rekomandimi nr. 2

Me qëllim që mbrojtja të jetë efektive, duhet që avokatët që caktohen kryesisht të trajnohen në mënyrë të vazhdueshme dhe duhet edhe të paguhen në mënyrë të përshtatshme.

Rekomandimi nr. 3

Avokatëve duhet t'u sigurohet kohë dhe lehtësira të mjaftueshme, si dhe akses i plotë në dosjen e çështjes me qëllim dhënien e ndihmës efektive ndaj të pandehurit, me qëllim që ky i fundit të marrë një vendim të informuar nëse marrëveshja për pranimin e fajësisë sjell përfitim për të. Kjo kërkon gjithashtu që çdo marrëveshje të mos arrihet menjëherë pas ngritjes së akuzës apo arrestimit të të pandehurit (pra në momentin kur policia dhe prokuroria nuk kanë shfrytëzuar ende mjaftueshëm kohë për të mbledhur prova të konsiderueshme kundër tij), por të bëhet në një fazë të mëvonshme. Ekzistenca e një prove të fortë (edhe pse jo domosdoshmërisht e mjaftueshme për një dënim) kundër të pandehurit do të zbuste gjithashtu çdo frikë të publikut që disa kategori të të pandehurve mund të trajtohen në mënyrë preferenciale. Në vijim të sa më sipër, nuk duhen përdorur stimuj për të nxitur marrëveshjen për pranimin e fajësisë gjatë fazës së hetimit paraprak, pasi nëse stimujt përdoren gjatë fazave shumë të hershme të hetimit, atëherë të pandehurit mund të ndihen të detyruar të lidhin menjëherë marrëveshjen, pavarësisht nëse mund të jenë të pafajshëm. Nuk duhet të ketë përfitime të konsiderueshme të pabalancuara në rastin e pranimit të fajësisë dhe pasojave negative për zgjedhjen e një gjykimi të rregullt, pasi sa më e madhe është kjo pabarazi, aq më shumë gjasa ka që i pandehuri të shtrëngohet për t'u pajtuar me heqjen dorë nga gjykimi.

Rekomandimi nr. 4

Gjykatat duhet të sigurojnë një shqyrtim efektiv – të arsyetuar – të aspekteve kryesore të çdo çështjeje të trajtuar me mekanizmin e heqjes dorë nga gjykimi, në veçanti të vlerësimit të vullnetit të të pandehurit, të përshtatshmërisë së dënimit të propozuar, të efektivitetit dhe përshtatshmërisë së ndihmës juridike që i është dhënë të pandehurit, si dhe të mjaftueshmërisë

prima facie të provave kundër të pandehurit. Me qëllim sigurimin që i pandehuri e ka kuptuar marrëveshjen, gjykata nuk duhet të mjaftohet thjesht me një pohim të thjeshtë të të pandehurit, por duhet t'i drejtojë atij një sërë pyetjesh që të krijohet bindja se i pandehuri e ka kuptuar realisht zgjedhjen e bërë duke hequr dorë nga gjykimi i çështjes dhe në këtë mënyrë t'i japë mundësinë atij që të reflektojë mbi vendimin e tij.

Rekomandimi nr. 5

Është thelbësore që të sigurohet e drejta për t'u ankuar (të paktën për çështje të ligjit), kundër vendimeve të miratimit të marrëveshjeve të fajësisë, në mënyrë që të sigurohet një mundësi shtesë e rishikimit të praktikës gjyqësore. Duhet të ekzistojë e drejta për ankim në rastet kur janë shkelur të drejta procedurale të domosdoshme në këtë lloj gjykimi, si mungesa e mbrojtësit, etj.

Rekomandimi nr. 6

Nevojitet të rregullohet me ligj detyrimi i prokurorit që të marrë një vendim të arsyetuar për refuzimin e marrëveshjes, me qëllim kufizimin e pushtetit të prokurorit.

Rekomandimi nr. 7

Ndonëse mungesa e kriterëve ligjore për ta lënë në zgjedhje të prokurorëve propozimin e një marrëveshje është e pritshme (sepse ky instrument përdoret sipas nevojave administrative dhe organi i prokurorisë duhet të ketë fleksibilitetin e duhur për ta zgjedhur ose jo përdorimin e tij) për të shmangur arbitraritetin është e nevojshme që drejtuesit e prokurorive, ose Prokurori i Përgjithshëm, sipas nevojave që paraqiten, të rregullojnë këtë proces përzgjedhjeje me anë të urdhërave dhe udhëzimeve të brendshme, për të mos e lënë një diskrecion të pakontrolluar në dorë të prokurorëve të çështjeve.

Rekomandimi nr. 8

Praktika e caktimit të avokatëve kryesisht sipas preferencave të prokurorëve do të mund të korrigjohet përmes një skeme të pavarur të caktimit me rotacion të avokatit kryesisht, sugjerim që Qendra Res Publica e ka bërë edhe në hartimin e udhëzimit përkatës në ndihmë të Ministrisë së Drejtësisë, për zbatimin e parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve të ndihmës juridike.

Qendra “Res Publica”
“Marrëveshjet e fajësisë - Si po shpërfaqet përdorimi i këtij
mjeti të ri juridik dhe si mund të balancohet roli i palëve për
një marrëveshje (më) të ndershme?”

Mbështetur nga:
Open Society Foundations


Tiranë, Shtator 2019

52 faqe

Format: 21 x 29.7 cm

Tirazhi 100 kopje

www.respublica.org.al



RESPUBLICA